



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë me Profile: Kontabilitet;
Bankë”**

ofruar nga

Universiteti “Metropolitan Tirana”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Ingrid Shuli

Prof. Asoc. Dr. Brikena Leka

Tetor/2024

**Tabela Përmbledhëse Për Programin e studimit Bachelor në “Financë me profile:
Kontabilitet; Bankë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti
“Metropolitan Tirana”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Metropolitan Tirana”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Financë -Bankë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Financë me profile: a.Kontabilitet; b.Bankë
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UAMS Nr.16,datë 19.01.2017
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr.65, datë 18.12.2020
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2021-2022: 7 PAE/13 PAK V.a 2022-2023:7 PAE/17 PAK V.a 2023-2024: 7 PAE/18 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2020-2021:15 studentë V.a 2021-2022:11 studentë V.a. 2022-2023: 5 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Metropolitan i Tiranës, është Institucion i Arsimit të Lartë Jopublik, të cilit i është dhënë leja për fillimin e veprimtarisë me VKM nr.519, datë 18.10.2011. Leja e dhënë nga MAS mundësoi hapjen e Fakultetit të Ekonomisë si dhe fillimin e studimeve të ofruar prej këtij Fakulteti që në vitin akademik 2011-2012.

UMT është akredituar si institucion 3 herë, ku në akreditimin e fundit me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.5, datë 27.01.2023, Institucioni është riakredituar për një periudhë 5 vjet, pra deri në 26.01.2028.

Bazuar në vendimin e MASR, nr 195, datë 01.04.2019 për riorganizimin institucional të UMT, aktualisht UMT ka në përbërje tre fakultete:

- Fakulteti i Ekonomisë;
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT;
- Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës;

Programi i studimit bachelor në Financë me Profile: Kontabilitet dhe Bankë ofrohet nga Departamenti Financë Bankë i Fakultetit të Ekonomisë. Ky program studimi është hapur për herë të parë në vitin akademik 2017-2018. Programi zhvillohet në formën me kohë të plotë, kohëzgjatje 3 vite akademike- 6 semestra dhe zhvillohet në gjuhën shqipe.

Programi i studimit Bachelor në, Financë me Profile: Kontabilitet dhe Bankë është licensuar me shkresë UMAS Nr. 16, datë 19.01.2017.

Ky program studimi është akredituar vetëm një herë, me vendim të Bordit të Akreditimit nr 65, datë 18.12.2020, me kohëzgjatje 3 vite akademike, me afat deri në datë 30.09.2023.

Duke qenë se në 4 vitet e fundit nuk ka studentë të regjistruar në profilin “Bankë”, UMT ka aplikuar për riorganizimin e këtij programi, duke e emërtuar në Bachelor në Financë, me profile “Kontabilitet” dhe “FinTech” në përputhje me kërkesat e tregut, si dhe bazuar në studimin e tregut të bërë nga ky institucion.

Fusha e studimit të programit të studimit bachelor Financë me profile: Kontabilitet dhe Bankë është shkenca ekonomike. Qëllimi i programit të studimit me anë të lëndëve në përbërje është të formësojë specialistë në fushën e financës, kontabilitetit dhe bankës. Përmeshja e qëllimit të këtij program studimi realizohet duke mundësuar studime të thelluara në Kontabilitet dhe Bankë, si edhe kompletimin e studentëve me njohuri mbi fushën e financës, veçanërisht të fokusuara në sektorin bankar dhe në financat e biznesit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 15.02.2023, Universiteti Metropolitan Tirana ka aplikuar pranë ASCAL për akreditimin për herë të dytë të programit të studimit bachelor në Financë me profile: Kontabilitet dhe Bankë. Ky program ofrohet nga Departamenti i Financë Bankë, i Fakultetit të Ekonomisë, të UMT-së. ASCAL bazuar në *“Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”* ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UMT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Ingrid Shuli, pedagoge në FEUT, Departamenti i Kontabilitetit dhe Prof. Asoc. Dr. Brikena Leka, pedagoge në FEUT, Departamenti i Financës. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknike e ASCAL, Alma Arapi.

Në datën 26.12.2023, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe agjenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 30 dhe 31 Janar 2024 në ambjentet e UMT-së. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 22.02.2024.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit bachelor Financë me profile- Kontabilitet dhe Bankë.

Në fund paraqiten rekomandimet për programin e studimit dhe kryhet një analizë SWOT mbi programin e studimit që akreditohet për herë të dytë. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 65, datë 18.12.2020, janë:

1. Mungesa në strukturën e planit mësimor të lëndëve dalluese/ diferencuese midis profile të këtij program studimi.
2. Në kundërshtim me rregulloren e programit të studimit, institucioni i lejon studentëve vetëm provimin me shkrim për përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse të programit të studimit.
3. Pamjaftueshmëria e literaturës fizike dhe elektronike në funksion të programit të studimit.
4. Roli i pamjaftueshëm i rrjetit Alumni në sigurimin e brendshëm të cilësisë për këtë program studimi.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Në planin mësimor janë përfshirë lëndë të cilat në mënyrë thelbësore bëjnë dallimin midis dy profileve: Kontabilitet dhe Bankë.
Prej 4 vitesh në këtë Institucion zhvillohet vetëm njëri prej profileve- Kontabilitet, pasi profili Bankë nuk kërkohet prej studentëve. Për këtë arsye UMT ka aplikuar për riorganizimin e këtij programi, duke e emërtuar Bachelor në Financë, me profile “Kontabilitet” dhe “FinTech”, në përshtatje me ndryshimet në treg, si dhe bazuar në studimin e tregut të bërë nga ky Institucion.
2. Institucioni ka konsideruar sugjerimin e BA dhe tashmë ofron përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse të programit të studimit:
 - Me punim diplome, për studentë me mesatare të lartë (8 e lart)
 - Me provim formimi, për studentë me mesatare nën 8.
3. Institucioni ka investuar në shtimin e literaturës fizike në bibliotekë, kryesisht në libra që përdoren si literaturë kryesore për secilën lëndë, duke ju ofruar edhe mundësinë studentëve që të përdorin këta libra gjatë periudhës që zhvillojnë lëndën në këtë program studimi. *Megjithatë, investimi në literaturë është përsëri i kufizuar dhe GJV përsëri sugjeron shtimin e fondit fizik në bibliotekë.* Ndërkohë nuk është investuar në abonime në biblioteka online. Aktualisht përdoret aksesit që kanë pedagogët në biblioteka online si student doktorature pranë Institucioneve të huaja. Prandaj *GJV përsëri sugjeron edhe regjistrimin në biblioteka online.*
4. Roli i rrjetit Alumni në Institucion është rritur ndjeshëm, në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe mundësimit të praktikave, realizimit të punimeve të diplomave/mikrotezave si dhe punësimit të studentëve.

Universiteti “Metropolitan Tirana”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 02.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 69 / 7 Prot, datë 02.10.2024. Universiteti “Metropolitan Tirana”, njofton në ASCAL më datë 07.10.2024, me anë të shkresës me Nr.153/1 Prot, datë 07.10.2024 “ Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë” me profile: “Kontabilitet”, “ Bankë “

OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Institucioni i Arsimit të Lartë - Universiteti “Metropolitan Tirana” ka hartuar programe studimi që janë në shërbim të interesave kombëtarë, duke u bazuar në kreun 1, neni 1 të Ligjit të Arsimit të Lartë, 80/2015. Në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit Metropolitan, theksohet se programet e studimit kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqenies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. Synimi mbetet, një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që ofron mundësi të barabarta për të gjithë, duke respektuar, njëherazi, etikën profesionale e shoqërore. Programi i studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë” është në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë Nr.80/2015, Strategjinë Kombëtare të Arsimit, Statutin e Universitetit Metropolitan dhe të gjithë bazën ligjore e nënligjore në fuqi. Ky program ka në qendër nevojat dhe interesat e studentëve, dhe mundëson përgatitjen e specialistëve të rinj në fushën e Financës me profile kontabilitet dhe bankë, fusha këto me rëndësi publike, në shërbim të interesave kombëtare. <i>[Aneksi Nr 2 Statuti UMT; Aneksi Nr. 03 Rregullore e Brendëshme UMT; Aneksi Nr. 04, Strategjia e Zhvillimit të UMT; Aneksi Nr. 05 Draft Strategjia 2022-2027-UMT; Aneksi Nr 10 Organigrama e FE në UMT; Aneksi Nr. 11 Rregullore e FE në UMT; Aneksi Nr. 12 Lista e programeve studimore që zhvillon FE në UMT; Aneksi Nr. 13 Lista e stafit akademik të brendshëm e të jashtëm angazhuar në FE për vitin akademik 2023-2024]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit Bachelor në “Financë” me profile: “Kontabilitet” dhe “Bankë”, sipas vizitës në institucion, dhe dokumentacionit përkatës, është ndërtuar në përputhje me qëllimet e misionin e UMT, të shprehura në Statutin e UMT, si dhe në Strategjinë e Zhvillimit të UMT dhe në dokumenta të tjera të rëndësishme lidhur me këtë program studimi. Diploma



	që ofrohet nga ky program studimi është gjithashtu në përputhje me fushën e veprimtarisë. Qëllimi i programit të studimit gjykohet e vlerësohet për të qenë sa më afër zhvillimeve ekonomike-shoqërore të vendit, kërkesave të tregut për specialistë të fushës së Financës me profile kontabilitet dhe bankë, për t'i përgjigjur edhe zhvillimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, pjesë integrale e domosdoshme për aplikimin e këtyre disiplinave tashmë. <i>[Aneksi Nr. 11 Rregullore e FE në UMT; Aneksi Nr 14 Rregullore e Programit të studimit; Aneksi Nr 15 Dosja e programit të studimit]</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Rezulton se programi i studimit Bachelor në “Financë” me profile: “Kontabilitet” dhe “Bankë” është hapur që prej vitit akademik 2017-2018 dhe është pjesë e Fakultetit të Ekonomisë UMT. Ky program ofrohet nga njësia bazë Financë Bankë dhe kurrikula e këtij programi është në përputhje të plotë me Strategjinë e zhvillimit të UMT. Po kështu, programi është në përputhje e në zbatim të fushave dhe drejtimeve akademike të UMT. Ky program studimi, sipas dokumenteve të rëndësishme si Statuti i UMT, Rregullorja e UMT, harton planin mësimor të çdo vit, si dhe programet apo syllabuset e lëndëve, në përputhje të plotë me kërkesat e tregut për të diplomuarit në “Financë” me profile: “Kontabilitet” dhe “Bankë”, duke i përgatitur studentët të vijojnë edukimin e kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë e të tretë të studimeve. <i>[Aneksi 04 Strategjia e Zhvillimit të UMT; Aneksi Nr. 05 Draft Strategjia 2022-2027-UMT; Aneksi Nr 15 Dosja e programit të studimit]</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Pas vizitës në institucion dhe dokumentacionit mbështetës vlerësohet se UMT, i themeluar dhe licesuar që në vitin 2011, ka përvojën dhe kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programeve të studimit. Pra UMT ka kapacitetet e duhura në fushën akademike për të ofruar këtë program studimi Bachelor në “Financë” me profile: “Kontabilitet” dhe “Bankë”. Personeli akademik i UMT është me grada e tituj dhe punon çdo vit për ngritjen e kapaciteteve, përmes bashkëpunimeve me universitete të vendit dhe të huaja, si dhe përmes projekteve në kuadrin e Erasmus +, por edhe të projekteve të tjera kombëtare e ndërkombëtare. <i>[Aneksi Nr. 13 Lista e personelit akademik me kohë të plotë e me kohë të pjesëshme – Tab.Nr. 2; Aneksi 16 Lista e stafit të angazhuar në programin e studimit]</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit	Programi i studimit Bachelor në “Financë” me profile: “Kontabilitet” dhe “Bankë”, sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve është program i nivelit 6 dhe është hartuar në

duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	përputhje të plotë me misionin e Universitetit Metropolitan Tirana. Po kështu, fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e këtij programi studimi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit Ekonomisë, si edhe me fushën akademike e kërkimore shkencore të personelit akademik që zhvillon mësim në këtë program studimi. Programi i studimit ofrohet pas studimit të tregut të punës dhe si kërkesë e tregut të punës për specialistë të Financës, Kontabilitetit dhe Sektorit Bankar, duke iu referuar programeve të njëjta në universitete perëndimore. <i>[Aneksi Nr 15 Dosja e programit të studimit]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>UMT e ofron programin e studimit në përputhje me misionin dhe qëllimin e deklaruar nga institucioni në Statutin e tij.</i> - <i>Ky program studimi ofrohet në fushat e veprimtarisë së institucionit dhe ka si synim ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</i> - <i>Programi i studimit paraqitet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe rregulloren e funksionimit të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së	UMT në dokumentet e rëndësishme si Statuti i UMT, Rregullorja e UMT, evidenton ndarjen e detyrave institucionale të njësive brenda institucionit UMT, Fakulteti Ekonomisë, Njësia Bazë Financë Bankë dhe krijimin e marrëdhënieve të mira mes tyre për të siguruar ecurinë e programit të studimit. I gjithë institucioni është i organizuar në funksion të realizimit të të gjithë elementëve të programit të studimit. Sipas organigramës së UMT rezulton se Njësia Bazë Financë Bankë bashkëpunon me njësitë bazë të Fakultetit të Ekonomisë si: Njësia Bazë e Informatikës Ekonomike, por bashkëpunon edhe me Fakultetin e Inxhinierisë e Arkitekturës dhe me Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe IT. Në analizën vjetore të secilës prej këtyre njësive, paraqitet veprimtaria akademike, ndihmës akademike dhe administrative-financiare.

vazhdueshme të punës së tyre.	Këto struktura administrative e akademike të institucionit bashkëpunojnë për mbarëvajtjen e programeve të studimit në kuadër të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare. <i>[Aneksi 02, Statuti i UMT; Aneksi 03, Rregullore e UMT; Aneksi nr.10 Organigrama e FE në UMT; Aneksi 11, Rregullore e FE në UMT; Aneksi 17, Vendim i Senatit Akademik mbi kompetencat dhe përgjegjësit e programeve dhe këshilltarëve akademikë në UMT; Aneksi 18, Vendim i Dekanit për emërimin e përgjegjësve të programeve të studimit dhe këshilltarëve akademikë në FE]</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se UMT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi, në zbatim të strategjisë së UMT, me universitete brenda e jashtë vendit, si dhe me institucione në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar. Në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit, duke zbatuar marrëveshjet e bashkëpunimit, UMT krijon mundësi për personelin akademik edhe për studentët për shkëmbime të eksperiencave më të mira, për leksione të hapura, për mundësi punësimi, për shkëmbime të personelit akademik dhe të studentëve me universitete si brenda dhe jashtë vendit. <i>[Aneks nr 19, Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT; Aneksi 20, Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE]</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se IAL ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione, kompani të sektorëve të ndryshëm, me qëllim kryerjen e praktikave mësimore nga ana e studentëve të këtij program studimi. Sipas dokumentacionit, janë 20 marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara për këtë qëllim. <i>[03 RVB Financë; Aneks 21, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në kuadrin e praktikave; Aneks 22, Programi I praktikës]</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se në respekt të akteve ligjore e nënligjore kryhen analiza vjetore të veprimtarisë mësimore e shkencore, në të cilat zë vend edhe diskutimi mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit të UMT, të Fakultetit të Ekonomisë me institucione, biznese, universitete, për përmirësimin e zbatimit të programit të studimit. <i>[03 RVB Financë; Aneks nr 23, Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të studentëve; Aneks 24, Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të stafit]</i>



Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - UMT ka lidhur marrëveshje të bashkëpunimit me institucione akademiko-kërkimore në vend, por edhe të huaja. - Institucioni ka lidhur marrëveshjeve të bashkëpunimit me biznese, institucione publike dhe private. - Në raportet vjetore të veprimtarisë mësimore dhe shkencore të UMT, Fakultetit të Ekonomisë dhe Njesisë Bazë Financë Bankë analizohen marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit të angazhuar në këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II.ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se në UMT organizimi i programit të studimit, është kryer në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, pika 2, me VKM nr.879, “Për disa ndryshime e shtesa në VKM 41, datë 24.01.2018 datë 18.12.2019 dhe VKM 185, dat 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.41, datë 24.01.2018”. Programi i studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë”, organizohet në lëndë ose module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Totali i krediteve (ETCS) është 180 ETCS, ku çdo vit studenti duhet të fitojë 60 kredite (ETCS). Kohëzgjatja është 3 vite akademike, me gjashtë semestra, forma e studimit me kohë të plotë, bazuar në suplementin e diplomës dhe në rregulloren e programit të studimit. Forma e studimeve është me kohë të plotë dhe gjuha e



	mësimdhënies është gjuha shqipe. Në përfundim të programit të studimit, ofrohet Diploma Universitare Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë”. <i>[03 RVB Financë; Aneksi 25, Plani mësimor i programit të studimit-Tab 10; Aneksi 26 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E)-Tab 9]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit synon të realizojë formimin e shprehive të veçanta për shumë lloje profesionale dhe specialitetesh si: financiar, kontabilist, bankier, analist i pasqyrave financiare, menaxher për financat dhe operacionet e ndryshme me organizata private e shtetërore, oficer kredie etj., siç paraqitet në dokumentacionin e programit të studimit. Në programin e studimit që po akreditohet janë vendosur objektiva të qarta për lidhjen me studimet e ciklit të dytë dhe me studimet e mëtejshme, si ato doktorale. Synim i rëndësishëm për këtë program studimi është të rrisë kompetencat profesionale të studentëve. Këtij synimi i shërben edhe përmirësimi i syllabuseve të lëndëve, aktivitetet e ndryshme në shërbim të rritjes së kompetencave profesionale, leksionet e hapura. Lektorët e këtij programi studimi sjellin në auditor metoda inovative për të aftësuar studentët. Në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të programit të studimit gjatë gjithë semestrave të studimit, studentët zhvillojnë lëndë bazë të detyrueshme, kombinuar me lëndët karakterizuese, dhe lëndë të tjera ndërdisiplinore dhe /ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje, ku studentët mund të zgjedhin lëndë specifike për formimin e shprehive e njohurive të veçanta të tyre. Në semestrin e fundit studentët realizojnë praktikën mësimore si dhe provim formimi apo temën e diplomës, në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë”. <i>[03 RVB Financë; Aneksi 25, Plani mësimor i programit të studimit – Tab 10]</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Sipas dokumentave nga institucioni dhe vizitës në UMT, konstatohet se ky program studimi ka objektivë të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë e kompetencat profesionale dhe praktike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit. Sipas VKM 41/2018, janë hartuar planet mësimore të këtij program studimi. Në planin mësimor të programit të studimit është përcaktuar qartë klasifikimi i lëndëve dhe vlerësimi i tyre me kredite sipas tipologjisë:

	▪ Kategoria A - Lëndë Bazë me 30 ECTS zënë rreth 17% të krediteve (nën kufirin maksimal - 20% të krediteve); ▪ Kategoria B - Lëndë Karakterizuese me 96 ECTS zënë rreth 53,3% të krediteve (brenda kufijve 50% - 55% të krediteve); ▪ Kategoria C - Lëndë Ndërdisciplinore me 27 ECTS zënë 15,00% të krediteve (brenda kufijve 12% - 15% të krediteve); ▪ Kategoria D - Lëndë Plotësuese me 21 ECTS zënë rreth 11,7% të krediteve (brenda kufirit 10%-15% të krediteve); ▪ Kategoria E – Detyrime Përmbyllëse me 6 ECTS zënë 3,33% të krediteve (brenda kufijve 3% - 5% të krediteve). Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese janë përlllogaritur duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. <i>[Aneksi 26 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E)-Tab 9; Aneksi 22 Programi i praktikës]</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas RVB dhe vizitës në UMT rezulton se Programi mësimor bachelor në “Financë” me profile Kontabilitet dhe Bankë, në planin mësimor të tij përfshin lëndën e praktikës profesionale si dhe detyrimet përmbyllëse (kategoritë D dhe E). Sipas Planit mësimor 2023-2024, dhe Rregullores së Programit të studimit Bachelor Financë me profile Kontabilitet e Bankë, detyrime përmbyllëse për këtë program studimi konsiderohen provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome, që vlerësohet me 6 kredite (ETCS). <i>[03 RVB Financë; Aneksi 26 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E)-Tab 9; Aneksi 22 Programi i praktikës]</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Sipas Rregullores së studimeve në UMT, neni 22 forma e organizimit të studimeve në programin Bachelor “Financë” me profile Kontabilitet dhe Bankë, është studim me kohë të plotë. Rregullorja e studimeve të UMT, Rregullorja e Programit të studimit Bachelor “Financë” me profile Kontabilitet dhe Bankë, japin informacione të nevojshme për studentët, qoftë për kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. UMT zbaton politika të financimit të studentëve të shkëlqyer apo dhe të studentëve përfitues në bazë të kriterëve të veçanta të vendosura me aktet nënligjore. Këto forma financimi zbatohen përmes bursave apo dhe përjashtimit nga tarifat e studimit, në bazë të vendimeve të Bordit të Administrimit të UMT. <i>[Aneks 03, Rregullore e brendëshme e UMT; Aneksi 26 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E)-Tab 9]</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që	Sipas dokumenteve dhe vizitës në UMT rezulton se programi i studimit Bachelor në “Financë” me profile Kontabilitet dhe

ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bankë, që zhvillohet në UMT, i është referuar dhe është mbështetur në masën 70% në programe studimi me të njëjtën emërtesë dhe që ofrohen në të njëjtën fushë studimi si edhe në universitete të tjera publike në Shqipëri, duke respektuar legjislacionin në fuqi. [03 RVB Financë]			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në zbatim të legjislacionit në fuqi, pra në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”, neni 86 dhe në VKM nr.310, dat 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH, njësia Bazë Financë Bankë në UMT ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit Bachelor në “Financë” me profile Kontabilitet dhe Bankë. Sipas RVB kodifikimi i programit Bachelor në “Financë” me profile Kontabilitet dhe Bankë emërohet: FAB XYZ-Kodi për lëndët e këtij program studimi. Përmes shkronjës X tregohet viti në të cilin zhvillohet lënda dhe Y, Z janë vazhdimet sipas numrit rendor. [03 RVB Financë; Aneksi 25, Plani mësimor i programit të studimit – Tab 10]			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Programi i studimit është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. - Ka ngjashmëri deri në 70% në emërtesë me programe të njëjta të ofruara nga IAL të tjera në vendin tonë. - Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Dokumentohet se Njësia Bazë Financë Bankë është përgjegjëse për programin e studimit dhe i përmbush detyrimet ligjore e nënligjore sipas nenit 25, të Ligjit për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” Nr. 80/2015. Fakulteti Ekonomisë në UMT, si njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit ka angazhuar gjatë vitit 2023-2024 evidenton 30 personel akademik, nga të cilët 15 personel akademik efektiv dhe 15 personel akademik me kontratë. Sipas Statutit të UMT, Fakulteti Ekonomisë përbëhet nga 3 njësi bazë (duke përmbushur përcaktimet ligjore përkatëse): • Departamenti i Financë Bankë, • Departamenti i Shkencave Administrative, • Departamenti i Informatikës Ekonomike. Departamenti Financë Bankë është njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit. Ai funksionon dhe organizohet sipas akteve rregullatore të UMT dhe në veçanti të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë. Njësia Bazë Financë Bankë ka përcaktuar koordinatoret për secilin nga programet e studimit që ofrohen nga ky departament, përfshirë edhe këtë program studimi, dhe koordinatorin për kërkimin shkencor. Departamenti i Financë-Bankë për tre vite akademike përbëhet si më poshtë:. <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>-</td><td>3</td><td>1</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>2</td><td>5</td><td>2</td><td>7</td><td>1</td><td>7</td></tr><tr><td>Dr/Phd</td><td>4</td><td>3</td><td>3</td><td>5</td><td>3</td><td>5</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td><td>3</td><td>1</td><td>4</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>7</td><td>13</td><td>7</td><td>17</td><td>7</td><td>18</td></tr></table> GVJ konstaton se numri i personelit akademik ka ardhur duke u rritur. Por, kemi patur rritje në numrin e personelit akademik me tituj e grada, konkretisht nga Doktor në Prof.Asoc. <i>[Aneksi 16 Lista e stafit të angazhuar në programin e studimit; Aneksi 29 Lista e personelit akademik ndihmës akademik dhe administrativ]</i> 3.Stafi akademik i DFB 2021-2024.pdf	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	-	3	1	2	2	2	Prof. Asoc.	2	5	2	7	1	7	Dr/Phd	4	3	3	5	3	5	Msc.	1	2	1	3	1	4	Gjithsej	7	13	7	17	7	18
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2021-2022		2022-2023		2023-2024																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof. Dr	-	3	1	2	2	2																																											
Prof. Asoc.	2	5	2	7	1	7																																											
Dr/Phd	4	3	3	5	3	5																																											
Msc.	1	2	1	3	1	4																																											
Gjithsej	7	13	7	17	7	18																																											

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Dokumentohet se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, për realizimin e këtij programi angazhon personel ndihmës akademik e administrativ. Kjo në bazë të rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe rregullores së programit të studimit. Sipas këtyre dokumenteve, krahas kooordinatorit të programit të studimit, njësia kryesore dhe njësia bazë mbështeten edhe tek personeli ndihmës akademik/administrativ, kështu janë punësuar pranë Fakultetit të Ekonomisë asistente administrative e FE, sekretarja mësimore, ndërsa stafi akademik ndihmës dhe stafi tjetër administrativ funksionojnë në nivel universiteti. Janë në total 32 punonjës ndihmës akademik e administrativ në nivelin e UMT. <i>[Aneksi 03 Rregullore e UMT; Aneksi 11 Rregullore e FE, UMT; Aneksi 29 Lista e personelit ndihmës akademik dhe administrativ]</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e kooordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në bazë të dokumenteve dhe sipas vizitës në institucion konfirmohet se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, në bazë të legjislacionit në fuqi ka caktuar me vendim kooordinatorin e programit të studimit. Për programin e studimit Bachelor në “Financë” me profile Kontabilitet dhe Bankë, kooordinator është një nga pedagogët e kësaj njësie bazë. Koordinatori bashkëpunon, koordinon e monitoron me strukturat e tjera përgjegjëse mbarëvajtjen e ecurisë së zhvillimit të mësimin, merret me zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë semestrit me studentët e personelin akademik, mban komunikim të vazhdueshëm me strukturat e njësisë bazë për informim të studentëve në lidhje me programin e studimit dhe detyrimet përmblylëse. si praktika profesionale, provimi i përgjithshëm apo diploma. <i>[Aneksi 17 Vendim i Senatit akademik mbi kompetencat dhe përgjegjësit e programeve dhe këshilltarëve akademikë të UMT, Aneksi 18, Vendim i Dekanit për emërimin e përgjegjësve të programeve të studimit dhe këshilltarëve akademikë në FE]</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Njësia kryesore - Fakulteti Ekonomisë dhe njësia bazë – Departamenti Financë Bankë, që janë përgjegjës për ofrimin e programit të studimit përmbushin standardet ligjore në fuqi lidhur me organizimin dhe strukturën e këtyre njësive. - Personeli ndihmës akademik dhe administrativ në shërbim të programit të studimit të angazhuar në ndjekjen e mësimin dhe orëve laboratorike, është i angazhuar në nivel njësie kryesore dhe universiteti. - Njësia bazë organizohet në grupe mësimore, kërkimore e shkencore, dhe ka përcaktuar kooordinatorët e programit të studimit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Sipas RVB dhe vizitës në institucion rezulton se për këtë program studimi përgjegjëse është njësia bazë, Departamenti Financë Bankë që disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e programit, për strukturën dhe përmbajtjen e tij. I gjithë informacioni rreth këtij programi qarkullon, ruhet, arshivohet në bazë të rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UMT. Edhe në faqen zyrtare të UMT mund të gjendet çdo informacion i vlefshëm për mirëfunksionimin e këtij programi studimi. Njësia kryesore, FE disponon rregulloren përkatëse, rregulloren e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset, CV e personelit akademik dhe informacione të tjera të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit. <i>[Aneksi 03 Rregullore e brendëshme e UMT; Aneksi 10 Organigrama e FE në UMT; Aneksi 11 Rregullore e FE në UMT; Aneksi 14, Rregullore e programit të studimit]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe, në tre vite akademike të ndarë secili në dy semestra me kohëzgjatje normale 15 javë. Lëndët janë të ndara sipas kategorive referuar përcaktimeve ligjore. Kurrikula e programit të studimit përmban 31 lëndë nga të cilat 3 lëndë me zgjedhje: në vitin e dytë zhvillohen dy lëndë me zgjedhje, një në semestrin e parë dhe një në semestrin e dytë. Studentit i krijohet mundësia të zgjedhë një nga dy lëndë të ofruara. Ndërsa, në planin mësimor në vitin e tretë parashikohet një lëndë me zgjedhje (studenti zgjedh 1 lëndë mes 2 lëndëve). Në vitin e parë zhvillohen 11 lëndë, në vitin e dytë zhvillohen 10 lëndë nga të cilat 8 lëndë të detyrueshme dhe 2 lëndë me zgjedhje (studenti zgjedh dy në 4 lëndë), ndërsa në vitin e tretë studentit zhvillon 7 lëndë të detyrueshme dhe 1 lëndë me zgjedhje (studenti zgjedh një në 2 lëndë), si edhe praktikën mësimore dhe diplomën (10 lëndë). Programi vlerësohet gjithsej me 180 kredite: • 5 lëndë/module të kategorisë A vlerësohen me 6 kredite; • 16 lëndë të kategorisë B vlerësohen me 6 kredite • 5 lëndë të kategorisë C vlerësohen: 1 lëndë me 3 kredite dhe 4 lëndë me 6 kredite



	• 4 lëndë të kategorisë D vlerësohen: 1 lëndë me 3 kredite dhe 3 lëndë me 6 kredite • Diploma e kategorisë E vlerësohet me 6 kredite. Për sa i përket orëve në auditor, program i studimit parashikon 1.825 orë në auditor, nga të cilat: • 600 orë në auditor gjatë vitit të parë; • 600 orë në auditor gjatë vitit të dytë. • 625 orë në auditor gjatë vitit të tretë, nga të cilat 25 orë për provimin e formimit apo diplomën. GVJ konstaton se ngarkesa në auditor është e balancuar dhe pothuajse uniforme midis semestrave. Plani mësimor parashikon edhe 2675 orë jashtë auditorit në formën e detyrave/projekteve dhe punës individuale. Pra, programi i studimit parashikon në total 4500 orë mësimore gjithsej. <i>[Aneksi 29, 30 Planet mësimore të programit të studimit Tab 9, Tab 10]</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit Bachelor në “Financë” me profile: Kontabilitet dhe Bankë, përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që synojnë këtë program studimi. Këto informacione kryesisht lidhen me kriteret e përgjithshme e specifike të pranimit, kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Institucioni bën njohjen e lëndëve sipas Rregullores së UMT, Kreu VI, fq 17, dhe nenit 45 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë. Në zbatim të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH”, kriteret specifike si dhe kuotat e pranimit të studentëve i propozon Njësia Bazë tek drejtuesi i njësisë kryesore e më pas propozimi kalon në rektorat për miratim. Në planet mësimore paraqiten lëndët, kreditet, orët e mësimit të ndara në leksione e seminare, orë në auditor e jashtë auditorit. Ndërsa, në syllabuset e lëndëve paraqitet informacion mbi lektorin/ët e lëndës, viti, semestri, raporti i orëve të leksioneve e të seminareve, përfitimet nga lënda, objektivet, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, mënyra e vlerësimit të studentit, literatura bazë dhe ajo plotësuese. <i>[Aneksi 27, Plan/Programi/Syllabuset e lëndëve]</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët	Sipas RVB dhe vizitës në institucion, dokumentohet se programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për syllabuset e lëndëve, ku përfshihet edhe ngarkesa mësimore në leksione e seminare. Ky program studimi disponon edhe informacion për gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018, VKM 879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr.185, datë 25.03.2021. Mbi këtë bazë ligjore është hartuar edhe Plani mësimor i Bachelor në Financë me profile Kontabilitet e Bankë



formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	2023-2024. Neni 40 i Rregullores së FE në UMT paraqet elementet e programeve të studimit të ofruara nga UMT, të vlefshme edhe për programin e studimit Bachelor në Financë me profile Kontabilitet e Bankë. Në përgjithësi syllabuset janë të unifikuara për sa i përket objektivave, temave të lëndës së bashku me çështjet për secilën temë, vlerësimin e studentit dhe literaturën bazë dhe të detyrueshme. GVJ konstaton se ngarkesa në auditor është e balancuar dhe pothuajse uniforme midis semestrave. Plani mësimor parashikon 1825 orë në auditor edhe 2675 orë jashtë auditorit në formën e detyrave/projekteve dhe punës individuale. Pra, programi i studimit parashikon në total për të tre vitet akademike, 4500 orë mësimore gjithsej. <i>[Aneksi 11 Rregullore e FE në UMT; Aneksi 27, Plan/Programi/Syllabuset e lëndëve]</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Sipas vizitës në institucion dhe dokumentacionit mbështetës, ky program studimi është në përmirësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik njësia bazë propozon deri në miratimin e tyre nga njësia kryesore e nga Senati Akademik, ndryshimet e mundshme dhe arkivohet dosja sipas legjislacionit në fuqi. Procedura e përditësimit është e tillë që fillon në departament propozimi për ndryshim në programet mësimore, psh., për ndryshime deri në 20%, ose më shumë, më pas diskutohet në dekanat dhe propozimet përfundimtare dërgohen për miratim në Senatin akademik të UMT. Konkretisht për programin Bsc në “Financë” me dy profile, është rishikuar/përmirësuar për vitin akademik 2023-2024 plani mësimor i programit në fjalë, ku kryesisht janë bërë saktësime në emërtimet e disa lëndëve, pa ndryshime në ECTS apo ngarkesë mësimore në auditor (vendimi i senatit akademik nr. 5, datë 31.03.2023). <i>[Aneksi 11 Rregullore e FE në UMT; Aneksi 14 Rregullore e Programit të Studimit; Aneksi 27, Plan/Programi/Syllabuset e lëndëve; Aneks 35 Praktika e miratimit e përmirësimit të kurrikulës për një program studimi]</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, i cili përmban elementet përkatëse të kërkuara në kuadrin ligjor. - Kuadri rregullator i UMT parashikon kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit



	në/nga programe të tjera si dhe mundësinë e ekuivalentimit të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Për këtë program studimi, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e ngarkesës mësimore sipas lëndëve dhe praktika mësimore si pjesë e programit, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive të studentëve për studime të mëtejshme apo punësim të tyre, në zbatim të VKM 41, datë 24.01.2018, VKM 879, datë 18.12.2019 dhe VKM 185, datë 25.03.2021. Përveç marrjes së njohurive në fushën e Financës, Bankave, Kontabilitetit, Manaxhimit, programi i studimit përmban edhe lëndë aplikative të fushës së teknologjisë së informacionit, duke i bërë të aftë studentët për përvetësimin e kompetencave, e aftësive praktike, që rrisin mundësitë e tyre për punësim. Në planin mësimor paraqiten elementët si: mësimi në auditor, në formën e leksioneve, seminareve, ushtrimeve, detyrave të kursit, laboratorëve, po kështu edhe orët jashtë auditorit, që lidhen me punën individuale të studentit. Po kështu, në planin mësimor studentët njihen edhe me elementet e vlerësimit të vazhdueshëm në lëndët përkatëse. Aktivizimi në leksione e seminare, përgatitja e detyrave të kursit, realizimi i testeve të ndërmjetme e përfundimtare, e bëjnë më interaktiv komunikimin student pedagog dhe nxitet mendimi i tyre krijues, praktik. Thellimit të njohurive teorike e praktike i shërbejnë edhe bashkëpunimet e UMT me institucione të tjera brenda e jashtë vendit, pjesëmarrja në programin Erasmus+, por edhe aktivitetet ekstrakurrikulare që zhvillon FE në UMT, si: vizita në kompani të ndryshme, organizimi i leksioneve të hapura, nga përfaqësues të njohur të biznesit, pjesëmarrje e studentëve në konkurse të biznesit e inovacionit, pjesëmarrja në konferenca studentore e shkencore në UMT. Me përfundimin e këtij program studimi studentët kanë mundësi punësimi në kompani vendase, por jo vetëm. <i>[Aneksi 15 Dosje e programit të studimit; Aneksi 25 Plani mësimor i programit të studimit-Tab 10]</i>

Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Konstatohet nga RVB dhe dokumentacioni vënë në dispozicion nga institucioni se lëndët/modulet, shpërndarja në vite akademike e semestra, vlerësimi i lëndëve në kredite e orë mësimore, orë në auditor e punë individuale e studentëve, mundësojnë realizimin e objektivave formues të programit të studimit dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe programeve lëndore, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestra sipas lëndëve dhe moduleve është përgjithësisht e balancuar dhe mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional në fushën kontabilitet, bankë e financë. Vlerësimi në kredite i lëndëve në secilën kategori është në përputhje me fokusin e çdo lënde, si dhe pesha e lëndëve për secilën kategori është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në planin mësimor lëndët janë të shpërndara në vite akademike, në semestra, në fillim paraqiten lëndët bazë, pastaj lëndët formuese, duke respektuar nivelin e 25 orëve në javë bazuar në kurrikulën e programit të studimit. Programi i studimit “Financë” me profile Kontabilitet dhe Bankë përmban 4500 orë në total, duke i lënë mundësi studentëve edhe për orë jashtë auditorit punë individuale, nga këto edhe 150 orë për përgatitjen e punimit të diplomës (studentëve me notë mbi 8). <i>[03_RVB_Financë; Aneksi 15 Dosje e programit të studimit; Aneksi 25 Plani mësimor i programit të studimit-Tab 10]</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Sipas dokumentave dhe vizitës në UMT, Programi i studimit Bachelor në “Financë” me profile Kontabilitet e Bankë është hartuar bazuar në programe të ngjashme brenda vendit, por edhe në programe studimi të ngjashme ndërkombëtare. Shkëmbimet e eksperiencave mes fakulteteve brenda e jashtë vendit, projektet Erasmus+, eksperiencat e pedagogëve të cilët kanë marrë pjesë në këto shkëmbime kanë ndihmuar përpjekjet për përmirësimin e programit të studimit. Struktura e programit në tërësi respekton raportet teori, praktikë, pra orë mësimi në auditor, leksione, seminare, orë laboratorike dhe punë individuale e studentit. Nëse i referohemi Planit Mësimor, çdo semestër ka 30 kredite, pra ngarkesa e një viti është 60 kredite, e ngjashme kjo me praktikat ndërkombëtare. Për çdo lëndë zhvillohen 2 orë leksioni, 2 orë seminari, apo laborator, në javë, duke i kushtuar rëndësi rritjes së aftësive të studentit për zbatimin e njohurive të marra në leksion. Lëndët dhe emërtimi i tyre në tërësi janë në përputhje me profilin e këtij program, i cili i përket fushës së Shkencave Ekonomike. <i>[Aneksi 25 Plani mësimor i programit të studimit – Tab 10; Aneksi 26 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E), Tab 9]</i>

Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Për këtë program studimi ndarja e elementeve të programit sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritje e realizim të objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitete dhe punësim në përfundim të studimeve, mbështetur në dosjen e riorganizimit të programit të studimit, e cila është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bazuar në kurrikulën e programit të studimit, ky program ndërthur formimin teorik të studentëve me formimin praktik. Për përmirësimin e programit të studimit njësia bazë dhe personeli i saj akademik, përveç eksperiencës së fituar, konsultohen me universitete me të cilat UMT bashkëpunon. Referuar planit mësimor, ndarja e orëve në auditor në leksione dhe seminare është si më poshtë: • Leksione - 830 orë mësimore • Seminare - 805 orë mësimore • Ushtrime - 20 orë mësimore • Detyrë Kursi - 20 orë mësimore • Laboratorë - 5 orë mësimore • Praktika mësimore - 120 orë mësimore • Diploma/Provimi final - 25 orë mësimore Raporti Teori (leksione) / Praktikë (ushtrime/seminare) rezulton 830 orë teori dhe 850 orë praktikë ose afërsisht 45% / 55%. Studentëve të këtij program u ofrohen mundësi të kryejnë mobilitete në kuadrin e programeve Erasmus +, por jo vetëm, duke qenë se veprimtaria formuese e këtij program është e ngjashme me programe të tjera të ngjashme në universitete të huaja. <i>[03_RVB_Financë; Aneksi 22, Programi i praktikës; Aneksi 25 Plani mësimor i programit të studimit – Tab 10]</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se programet e lëndëve/modulet e programit të studimit, përditësohen vazhdimisht në njësinë bazë, departament. Miratohen nga Departamenti Financë-Bankë në fillim të vitit akademik. Programet e lëndëve, syllabuset, janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë ngarkesën semestrale të lëndës për 15 javë, të ndarë në orë leksioni, seminari, ushtrime, detyrë kursi, laboratorë. Syllabuset saktësojnë objektivat e lëndës, përfitimet nga lënda, me qëllim që studentët të marrin aftësitë e duhura profesionale, kompetencat e duhura, sipas kërkesave të tregut. Këto programe lëndësh përfshijnë edhe literaturën bazë, të detyrueshme edhe atë plotësuese. Në leksionin e parë të çdo lënde pedagogu informon studentët për të gjithë elementet e programit të lëndës, për mënyrën e vlerësimit të lëndës, për literaturën bazë dhe plotësuese që do shfrytëzojnë për përvetësimin e lëndës. Literatura në syllabus është e përditësuar me botime të reja.

	Nga vizita në bibliotekë rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, revista dhe botime të institucioneve të tjera; e cila mund të shfrytëzohet njëlloj nga të gjithë studentët dhe stafi i universitetit, megjithatë kjo literaturë edhe pse është zgjeruar në krahasim me listën e titujve në akreditimin paraardhës, përsëri është e kufizuar dhe e vogël në numër. Ndërkohë që Institucioni nuk ofron akses për bibliotekë online për studentët, por kryesisht përdor aksesin që kanë në këto biblioteka staf akademik që ndjekin programe doktoratë apo programe kërkimi pranë Universiteteve të huaja. <i>[Aneksi 27, Plan/Programi/Syllabuset e lëndëve]</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Dokumentohet nga institucioni, se rezultatet e pritshme të të nxënësve pas tre viteve të studimit, janë rritja e aftësive, e kompetencave, e mundësive për të gjetur punë në përputhje me shkollimin, mundësi për të vijuar më tej studimet. Fakulteti i Ekonomisë dhe njësi bazë, Departamenti Financë Bankë analizojnë ecurinë e programit të studimit, duke marrë opinionet e pedagogëve, studentëve aktualë dhe atyre alumni, për programet e lëndëve. Në analizën e ecurisë së programit pasqyrohen edhe rezultatet e pritshme pas përfundimit të lëndës si edhe përfitimet e studentëve nga lënda/ët. Rezultatet e të nxënësve maten përmes realizimit të objektivëve të lëndës, përfitimeve nga lënda, aftësive e kompetencave që pritet të përfitojë studenti pas përfundimit të lëndës. Përfshirja në planet mësimore e lëndëve me natyrë shumë disiplinash i përgatit studentët me njohuri e aftësi, kompetenca e zotësi për të vepruar në disa fusha si: Financë, Bankë, Kontabilitet, Manaxhim, Sisteme kompjuterike kontabiliteti, e për t'i përshtatur studentët për zhvillimet e tregut të punës. <i>[Aneksi 25 Plani mësimor i programit të studimit – Tab 10; Aneksi 26 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E), Tab 9; Aneks 35 Praktika e miratimit e përmirësimit të kurrikulës për një program studimi]</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Sipas RVB dhe vizitës në institucion konstatohet se programi i studimit Bachelor në Financë me profile: Kontabilitet dhe Bankë ka përmbajtjen e duhur dhe u krijon studentëve mundësi për vijimësinë e mëtejshme të studimeve në programet e studimit të nivelit të dytë Master pranë Fakultetit të Ekonomisë apo edhe në universitete të tjera publike e jopublike. Nëse i referohemi Planit mësimor vërejmë se përmes lëndëve Financë, Taksim Biznesi, Analizë Financiare, marrin aftësi teorike e praktike që trajtojnë instrumente të drejtimit të njësive ekonomike, ndërsa lëndë si Informatikë, Kontabilitet Kosto Drejtimi, Investime, Paraja dhe Banka, Drejtim Financiar, u japin studentëve njohuritë e aftësitë e duhura për t'u përshtatur me

	kërkesat e tregut të punës në fushat e financës e të bankës. Detyrat e kursit, praktika mësimore, përgatitja e diplomës janë lëndë të rëndësishme që i aftësojnë studentët për të trajtuar çështje të caktuara, për një aktivitet apo veprimtari të caktuar. [03_RVB në Financë; Aneksi 27, Plan/Programi/Syllabuset e lëndëve; Aneksi 30, Studim tregu për programin e studimit]			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, shpërndarja mes veprimtarive formuese, raporti teori-praktikë dhe ngarkesa në kredite janë në përputhje me profilin e programit të studimeve në fushën e kontabilitetit e financës.</i> - <i>Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara sipas kërkesave të tregut të punës dhe mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve të thelluara në cikle studimi më të larta.</i> <i>GVJ sugjeron shtimin e titujve fizikë në bibliotekë, si dhe regjistrimin në biblioteka prestigjioze online.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			x	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konstaton se programi i studimit, është ndërtuar në mënyrë të tillë që kombinon teorinë me praktikën më të përparuar në fushën e financës, kontabilitetit dhe bankës, me qëllim që studentët të përdorin aftësitë e fituara në këto fusha në njësi ekonomike publike e private, apo në biznese të sektorëve të ndryshëm. Ky program studimi ka për synim plotësimin e kërkesave të tregut për studentë të përgatitur për profesionin e kontabilistit e bankierit. Studimi i tregut, panairët që zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, studentët alumni të cilët sugjerojnë për përmirësime të kurrikulës, i shërbejnë arritjes së këtij synimi. Institucioni ka lidhur marrëveshje si me institucione, me biznese, me qëllim që studentët të kenë mundësi të marrin informacion për këto mundësi edhe përmes aktiviteteve të përbashkëta që zhvillon institucioni UMT.

	UMT ka përmirësuar përmbajtjen e programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut, duke përmirësuar kurrikulat mësimore. <i>[03_RVB_Financë; Aneksi 20 Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE; Aneksi 21 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në kuadrin e praktikave; Aneks 30 Studimi i tregut të punës]</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Dokumentohet se UMT nxit e garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje. Studentët janë angazhuar në Senatin Akademik të UMT, janë të përfshirë në Këshillin Studentor të UMT dhe kanë Statutin në bërë të të cilit funksionon ky këshill. Përmes zyrës Alumni, Zyrës së Këshillimit të karrierës Dekanit të studentëve, UMT mban kontakte me studentët e diplomuar, konsultohet me ta për përmirësimin e programit të studimit, pasi ata sjellin eksperiencat e tyre të punës të vlefshme për t'i pasqyruar në programet e lëndëve dhe në programin e studimit në tërësi. Studentët vlerësojnë procesin akademik përmes plotësimit të pyetësorëve drejtuar atyre nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, duke ndihmuar institucionin të përmirësojë cilësinë. Në zbatim të legjislacionit në fuqi UMT, Fakulteti i Ekonomisë, në kuadrin e programit të studimit ka ngritur dhe ka funksional Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, duke zbatuar strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>[Aneksi 31 Rrjeti Alumni UMT]</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	UMT, në veçanti Njësia Bazë Financë Bankë, në FE, përgjegjëse për përmirësimin e programit të studimit në përputhje me kërkesat e zhvillimet e kohëve të fundit në fushën e Financës, Kontabilitetit, Bankës, bashkëpunon me njësi ekonomike publike, private, me institucione publike e private, me studentët Alumni të viteve të kaluara, merr parasysh propozimet e tyre për përmirësim e përditësim të syllabuseve të lëndëve, të programit të studimit, për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut. Pjesa e personelit akademik të NJBFB është pjesë e strukturave vendimmarrëse e konsultuese të institucioneve e organizatave publike e private, me të cilët bashkëpunojnë, dhe sjellin në auditorë e pasqyrojnë në programin e studimit të rejat dhe propozimet e bëra edhe prej këtyre partnerëve e bashkëpunëtorëve. <i>[Aneksi 19 Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT]</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - UMT është i angazhuar në një program të vazhdueshëm të përmirësimit të kurrikulave të të gjitha programeve që ai ofron duke reflektuar opinione të palëve të përfshira, si studentët dhe përfaqësues të institucioneve e organizatave publike e private.



	- Institucioni angazhohet që të përmirësojë programin e studimit nëpërmjet bashkëpunimit me aktorë të tregut, në mënyrë që të garantohet një proces serioz dhe cilësor i hartimit/rishikimit të kurrikulave të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III.MËSIMDHËNIA,MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Referuar dokumentave shoqëruese të RVB, GVJ konstatoi se UMT si IAL dhe FE si pjesë e tij në zbatim të legjislacionit në fuqi përdorin forma të larmishme të mësimdhënies dhe angazhohen që procesi mësimor dhe veprimtaritë e tjera akademike të kryhen sipas planit mësimor të cdo lënde, i ndarë në leksione, seminare, laboratorë. Po kështu përdoren metoda të shumta të tejçimit të dijeve e njohurive tek studentët nga personeli akademik i FE. Bazuar në dokumente si: Rregullore e brendëshme e UMT, Rregullore e Fakultetit Ekonomisë, dhe në planin mësimor Bachelor Financë me profile Kontabilitet e Bankë, ngarkesa ndahet në leksione, seminare, detyra kursi, laboratorë. Zbatohen forma të kontrollit të vazhdueshëm, leksionet e hapura dhe çdo formë tjetër e mësimdhënies e miratuar nga institucioni, UMT. Në programin e lëndës specifikohen edhe detyrimet e studentit për të shlyer lëndën si test i ndërmjetëm, provim përfundimtar, detyrë apo projekt kursi, praktika profesionale në dy javët e fundit të semestrit, të gjitha këto në shërbim të transmetimit të dijeve e njohurive tek studentët. [03_RVB_Financë; Aneksi 2 Statuti i UMT; Aneksi 03 Rregullore e brendëshme e UMT; Aneksi 04 Strategjia e zhvillimit të UMT;



	<i>Aneksi 11 Rregullore e FE në UMT; Aneksi nr 15 Dosja e programit të studimit; Aneksi 27 Plan/program/Syllabuset e lëndëve]</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	UMT, përmes programit të studimit, ofron kurrikul në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të përshtatur me kushtet e tregut. Procesi i mësimdhënies kryhet nga ana e personelit akademik duke përdorur metoda alternative mësimdhënie e mësimnxënie, duke iu përgjigjur nevojave e interesit të studentëve. Gjatë zhvillimit të lëndëve sipas planit mësimor, realizohen edhe leksione të hapura nga përfaqësues të institucioneve publike apo private, përfaqësues të biznesit, mësim në laboratore, seanca ushtrimesh e diskutimesh, si dhe prezantim i projekteve të kursit në grup. Gjatë periudhës së pandemisë, mësimi u zhvillua online përmes platformave elektronike të mësimit në distancë GoToMeeting-GMT, Teams, etj., si dhe sistemin e informacionit edu4school. Ky sistem ka shërbyer si për studentët edhe për pedagogët, për të evidentuar mungesat, për të hedhur materialet si leksione, ushtrime, detyra, për të bërë vlerësimin e studentëve si për testet e ndërmjetme ashtu edhe për provimin përfundimtar. UMT mundësoi edhe trajnime për përdorimin e këtyre platformave për personelin akademik, duke përgatitur edhe manual përdorimi për studentët. Në planin mësimor të programit të studimit Bachelor “Financë” me profile Kontabilitet dhe Bankë, përfshihen edhe veprimtaritë formuese, “lëndët me zgjedhje, veprimtari alternative të programit që u mundëson studentëve të përzgjedhin një lëndë mes një grupi lëndësh. <i>[Aneksi 32 Rezultatet e studentëve të viteve të para në Fakultetet e UMT për vitin akademik 2022-2023]</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Në UMT personeli akademik i angazhuar në programin e studimit mban grada e tituj shkencorë, është me eksperiencë disa vjeçare e me përvojë në mësimdhënie si në universitete shtetërore dhe në ato private. Gjatë zhvillimit të orëve të leksionit e të seminareve, lektorët zhvillojnë mësimin në mënyrë interaktive, pra duke përfshirë edhe studentët në diskutim përmes pyetjeve që drejton lektori apo pedagogu në sallë dhe diskutimit në detaje të çështjes duke përfshirë edhe studentët në diskutim. UMT mbështet personelin akademik duke i nxitur të bëhen pjesë e programeve të shkëmbimit të stafëve me Universitete të tjera partnere në Evropë apo vendet e rajonit, me të cilat UMT ka marrëveshje. Mbështetja e stafëve nga UMT bëhet me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës përmes; përmirësimit të infrastrukturës së mësimdhënies, në auditorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies; laboratorëve për zhvillimin e disa lëndëve me karakter praktik si



	Sisteme Kompjuterike kontabiliteti; përmes mobiliteteve të personelit akademik, pjesmarrjes në trainime e workshope, në kuadrin e projekteve me partnerë të huaj, me qëllim përsosjen e metodave të mësimdhënies. <i>[Aneksi 33 Udhëzues për planin e mobilitetit për stafin akademik në kuadër të Erasmus+]</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Financë” me profile Kontabilitet dhe Bankë, ka tituj e grada shkencore që i kanë fituar brenda dhe jashtë vendit, por janë edhe profesionistë në praktikën kombëtare e ndërkombëtare. Personeli akademik ka kualifikimet e duhura për të dhënë mësim në këtë program studimi, është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, brenda fushës së studimit Kontabilitet dhe Bankë, përmbush kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit. Sipas dokumentacionit të paraqitur, për vitin akademik 2023-2024, personeli akademik i Njesisë Bazë Financë Bankë përbëhet nga 30 tridhjetë personel akademik, sipas kategorive të mëposhtme: • 15 PAE , nga të cilët, 2 me titull akademik Profesor Dr.; 3 me titullin “Profesor i Asociuar”, 8 me gradën “Doktor; dhe 2 Msc. • 15 PAK, nga të cilët 3 me titull Profesor Dr, 7 me titullin “Profesor i Asociuar”, 4 me gradën Doktor dhe 1 me Msc. GVJ konstaton se numri i personelit akademik ka ardhur duke u rritur. Por, kemi patur rritje në numrin e personelit akademik me tituj e grada, konkretisht nga Doktor në Prof.Asoc. <i>[Aneksi 34 Personeli akademik i programit studimit]</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Dokumentohet se Departamenti Financë Bankë përgjegjës për programin e studimit, cdo vit akademik merr në shqyrtim syllabuset e lëndëve , ku përfshihen edhe format e mësimdhënies. Në këtë proces diskutohen sugjerimet e studentëve aktualë dhe atyre alumni. Zyrat e studentëve në fakultet marrin opinionet e tyre, po kështu edhe këshilltarët akademikë. Shqetësimet e studentëve i kalojnë departamenteve. Në departament zhvillohen analiza vjetore si për mësimin edhe për punën kërkimore, pasi merret opinion i të gjithë personelit akademik sipas lëndëve / disiplinave. Në këtë analizë vjetore departamenti vlerëson përputhshmërinë e metodave të mësimdhënies me objektivat formues, të përcaktuar në dokumente si: rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, rregullore e programit të studimit. Studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të metodave të




	mësimdhënies, përmes përgjigjeve të dhëna prej tyre në pyetësorët e shpërndarë nga NJSBC. Sugjerimeve të tyre për më shumë lidhje të teorisë me praktikën Fakulteti e Departamenti iu janë përgjigjur duke shtuar mundësitë për bashkëpunime me bizneset apo për zhvillimin e disa lëndëve apo temave në laboratorë. <i>[Aneksi nr 11 Rregullore e FE; Aneksi 14 Rregullore e programit të studimit]</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Nga dokumentet dhe vizita në UMT rezultojnë se janë ngritur të gjitha strukturat për garantimin e cilësisë së mësimdhënies. Bazuar në Statutin e UMT, njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor – kërkimor janë: a. Sektori i Kurrikulës, Cilësisë, këshillimit të studentëve dhe Alumni; b. Sektori i Kërkimit dhe Projekteve. Këto struktura të ngritura në nivel UMT e të Fakultetit ndikojnë në përmirësimin e mësimdhënies, përmes zhvillimit të mësimin në mënyrë interaktive, nxitjes së debateve, mendimit kritik, rasteve studimore, punës në grup për përgatitjen dhe prezantimin e punimeve të kursit. Strukturat e ngritura në funksion të përmirësimit të cilësisë marrin opinionet e studentëve dhe i transmetojnë ato në nivelet e larta të drejtimit dhe në departament, siç është rasti i përmirësimit të syllabuseve të lëndëve. UMT ka të saktësuar në politikat e veta edhe trajnimin e personelit akademik, si dhe sigurimin e kushteve për pjesëmarrje në mobilitete në universitete të huaja në kuadër të programeve Erasmus+. <i>[Aneksi 35 Praktika e miratimit të përmirësimit të kurrikulave për një program studimi; Aneksi 36 Raport i Drejtorisë së komunikimit për studentët 2017-2023]</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Programi i studimit përmban formë të shumëllojshme të mësimdhënies dhe mësimxënies mbështetur në aktet rregullatore të institucionit dhe në funksion të arritjes së synimeve të programit. - Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive, - Procesi mësimor është i fokusuar tek studenti për të lehtësuar mësimxënien dhe karakterizohet nga praktikën më të mira. - UMT mbështet kualifikimin në drejtim të përmirësimit të kompetencave didaktike të stafit.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni UMT, si Rregullore e UMT, Rregullore e FE, Rregullore e programit të studimit, Rregullore e provimeve, konstaton se IAL ka përcaktuar në këto dokumente kriteret dhe mënyrat e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve e aftësive profesionale. Në programin e lëndës specifikohen edhe detyrimet e studentit për të shlyer lëndën si test i ndërmjetëm, provim përfundimtar, laborator, detyrë apo projekt kursi, të gjitha në shërbim të transmetimit të dijeve e njohurive tek studentët. Rregulloret janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit: www.umat.edu.al . Studentët gjejnë të gjitha informacionet e nevojshme rreth programit të studimit, në veçanti rreth kriterëve të vlerësimit të njohurive. <i>GVJ konstaton se institucioni nuk ka Rregullore të njësisë bazë Financë Bankë.</i> <i>[03 RVB Financë; Aneksi 37 Rregullore e provimeve]</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se UMT dhe Fakulteti Ekonomisë kanë miratuar aktet nënligjore në zbatim të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në RSH”, lidhur me mënyrën e vlerësimit të studentëve të ciklit të parë. Më konkretisht, në rregulloren e programit të studimit, Kreu V, neni 24, në rregulloren e Fakultetit Ekonomik, Kreu V, neni 63. Nisur nga rregulloret, shihet se studentët informohen për mënyrën e vlerësimit të dijeve të tyre, përmes skemës së vlerësimit me pikë dhe të konvertuara në notë, konkretisht pikët totale ndahen në këtë mënyrë: në pjesëmarrje e aktivizim në leksione e seminare, testi i ndërmjetëm, projekti apo detyra e kursit, provimi përfundimtar. Ky informacion i rëndësishëm u jepet studentëve qysh ditën e parë të nisjes së lëndës, apo në leksionin e parë, kur bëhet edhe prezantimi i programit të lëndës. <i>[Aneksi 11 Rregullore e FE; Aneksi 14 Rregullore e programit të studimit; Aneksi 38 Modeli i vlerësimit të studentëve gjatë semestrit dhe në provimet finale]</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive,	Sipas RVB në Rregulloren e studimeve në UMT, saktësohet mënyra e testimit të njohurive të studentëve. Mënyra e



dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	vlerësimit të studentëve paraqitet edhe në syllabuset e lëndëve, si element i rëndësishëm i programeve të studimit. Vlerësimi i studentëve bëhet përmes këtyre elementëve: testi i ndërmjetëm, provimi final dhe vlerësimi i vazhduar, ku përfshihen testi i ndërmjetëm dhe aktivizimi në seancat e seminareve. Totali i pikëve të fituara nga studenti në të gjithë këta elementë, mundëson vlerësimin e studentit me notë për lëndën përkatëse. Studentët e marrin informacionin për detyrimet e tyre në lëndë përveç se nga rregulloret edhe nga lektori ditën e parë të mësimit në atë lëndë. <i>[03_RVB_Financë; Aneksi 38 Modeli i vlerësimit të studentëve gjatë semestrit dhe në provimet finale]</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sUMTerimet e tyre.	Sipas RVB dhe dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni, personeli akademik i Njesisë Bazë F-B, përmirëson metodat e mësimdhënies periodikisht, duke marrë edhe mendimin e studentëve. Këto mendime e sugjerime merren përmes pyetësorëve që shpërndan tek studentët NJSBC, për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, zbatimin e programit mësimor, metodat që përdoren nga pedagogu për të dhënë mësimin, për vlerësimin e studentit në testime apo në provim etj. <i>[03_RVB_Financë; Aneksi 37 Rregullore e provimeve]</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga vizita në institucion dhe nga dokumentacioni konstatohet se UMT krijon mundësi për përdorimin e metodave të larmishme të mësimdhënies, sipas rezultateve të pritshme të të nxënit dhe objektivave formues dhe kërkesave të tregut të punës për studentët e këtij program studimi. Duke përdorur infrastrukturë bashkëkohore për mësimdhënie, si laboratorë ku janë instaluar programe kompjuterike të specializuara, duke nxitur e krijuar mundësi për mobilitete të personelit akademik në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, përmes përdorimit të platformave on line për të zhvilluar mësimin. Komunikimi me studentët qoftë në orët e mësimit, në orët e konsultimit, përmes email, krijon kushte për ecurinë më të mirë të studentëve, si gjatë përgatitjes së detyrave të lëna në klasë nga pedagogu edhe gjatë kohës së përgatitjes së tyre për provim. Lirshmëria në komunikim dhe krijimi i marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre dhe pedagogëve nxisin edhe ndjenjën e autonomisë tek studenti. <i>[Aneksi 37 Rregullore e provimeve; Aneksi 40 Rregullore e sekretarisë]</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Në rregulloren e institucionit, njësisë kryesore dhe të programit jepen sistemi i vlerësimit, format e vlerësimit

	dhe format e kontrollit të dijeve, dhe njihen nga studentët. - Vlerësimi përfundimtar i studentit kryhet nëpërmjet vlerësimit gjatë semestrit, detyrave dhe projekteve të kursit si edhe vlerësimit gjatë testimeve të lëndës. - Në fillim të çdo viti akademik studentët informohen për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve. - Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces. - Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e tregut.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar dokumenteve shoqëruese të RVB, GVJ konstatoi se në UMT vlerësimi i njohurive dhe i aftësive të fituara nga studentët realizohet nëpërmjet: testeve ndërmjetëse, detyrave të shtëpisë, detyrave të kursit dhe provimeve përfundimtare. Mënyra e testimit dhe vlerësimi i njohurive dokumentohet në Rregulloren e programit të studimit, Kreu V, neni 24, në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu V, neni 63, dhe në syllabuset e lëndëve. Në syllabus përcaktohet se vlerësimi i lëndës bëhet duke grumbulluar pikët e provimi final, i cili vlerësohet 60-70% sipas lëndëve dhe vlerësimi i vazhduar, i cili zë 30-40%, ku përfshihen testi i ndërmjetëm dhe aktivizimi në seancat e seminareve. Informacioni për vlerësimin e lëndës u jepet studentëve në fillim të procesit mësimor nga pedagogu i lëndës. Në përfundim të procesit mësimor pedagogu u komunikon studentëve vlerësimin e vazhduar me pikë, dhe nëse u takon të futen në provim ose jo, në varësi të frekuentimit të lëndës. Studentët kanë mundësi të hyjnë në provim për të marrë notë kaluese apo për përmirësim note tre herë: në sezonin e dimrit, në sezonin e verës dhe në sezonin e vjeshtës. Ndërsa, mundësitë për t'u diplomuar janë dy: në Korrik dhe në Shtator.

	<i>[03_RVB_Financë; Aneksi 11 Rregullore e FE; Aneksi 14 Rregullore e programit të studimit; Aneksi 38 Modeli i vlerësimit të studentëve gjatë semestrit dhe në provimet finale]</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për të rritur transparencën dhe saktësinë në vlerësimin e studentëve sipas RVB, Fakulteti Ekonomisë ka në zbatim një projekt pilot për testimin nëpërmjet sistemeve elektronike konkretisht në sistemin edu4school (është një shërbim i ri për vlerësimin e dijeve të studentëve nëpërmjet këtij sistemi, i cili pas përfundimit të fazës së pilotimit, pritet të zbatohet në nivel institucional) sipas një rregulli që ruan konfidencialitetin dhe rrit shpejtësinë e kontrollit të testeve. Sipas kësaj forme përgjigja e provimeve i vjen në kohë reale pedagogut, së bashku me analizë të rezultateve e kalueshmërisë. Kjo është mundësi e mirë për korrigjimin e provimeve që zhvillohen me alternativa, pasi siguron shpejtësi e saktësi në përgjigjet dhe vlerësimin e studentëve. Në Rregulloren e programit të studimit parashikohen, edhe forma të tjera testimi bazuar në llojin e lëndës si dhe mundësisë së zhvillimit në laborator apo në auditor. Sipas RVB dhe dokumentave të programit të studimit, vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe rregulloret përkatëse ku mbështetet ky program. <i>[03_RVB_Financë; Aneksi 11 Rregullore e FE; Aneksi 14 Rregullore e programit të studimit]</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Bazuar në RVB e dokumentet e institucionit, si Rregulloren e UMT, bazuar edhe në syllabuset e lëndëve, GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga: vlerësimi i vazhduar prej 30-40 pikë apo 30-40% dhe provimit përfundimtar me 60-70 pikë apo 60-70%. Studentët informohen mbi vlerësimin e lëndës qysh në momentin që njihen me programin, syllabusin e lëndës, mbi intervalin e notave dhe të gjitha detyrimet e lëndës. Vlerësimi përfundimtar i njohurive, aftësive e kompetencave të studentëve në çdo lëndë realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë). <i>[Aneksi 03 Rregullore e brendëshme e UMT; Aneksi 37 Rregullore e provimeve]</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi	Bazuar në dokumenta dhe vizitën në institucion, takimin me studentët, GVJ konstaton se studentit i krijohet mundësi të ketë vlerësim të plotë përmes disa elementeve, jo vetëm me provim, por edhe përmes testeve ndërmjetëse, punëve të laboratorit, detyrës apo projektit të kursit dhe provimit përfundimtar. Bazuar në rregulloren e provimeve, studentit i jepet mundësia të diskutojë në klasë rezultatet e provimit të parë, me qëllim që të përmirësojë rezultatet



procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	në provimin përfundimtar. Pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta të rishikojnë tezat e korrigjuara prej komisionit të provimit, të ballafaquar edhe me zgjidhjen, për të parë vlerësimin që u është bërë. Marrin me këtë rast edhe komente e këshilla nga pedagogët e lëndës për të përmirësuar arritjet e tyre në provimin përfundimtar. Po kështu, edhe detyra e kursit si punë në grup dhe prezantim në klasë si grup i nxit studentët të përmirësojnë vlerësimin e tyre krahasuar me vlerësimin që kanë patur në provim. GVJ konstaton se në syllabuset e lëndëve në seksionin e vlerësimit të lëndës si pjesë të kontrollit e vlerësimit të vazhduar është edhe konsultimi me studentët. Kështu, në çdo lëndë studentët kanë mundësi tre herë gjatë semestrit, si rregull në fund të javës së 5, 10 dhe 15 të zhvillohen nga 2 orë konsultime. <i>[Aneksi 27.2 Syllabuset e lëndëve të vitit të parë semestri dytë; Aneksi 37 Rregullore e provimeve; Aneksi 38 Modeli i vlerësimit të studentëve gjatë semestrit dhe në provimet finale]</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Njësia Bazë Financë Bankë dhe personeli akademik respektojnë rregulloren e brendshme të UMT, Kodin e Etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes së provimeve, dhe masat ndëshkuese në rast plagjiature. Bazuar në rregulloren e provimeve, në rregulloren e Fakultetit Ekonomisë, procesi i provimeve zhvillohet më të paktën dy vetë komision provimi, lektori dhe pedagogu i seminareve, për të shmangur plagjiaturën apo kopjimin. Studentët detyrohen të respektojnë Kodin e Etikës së UMT, përfshirë edhe dispozitat e këtij kodi që parashikojnë sjelljen e tyre (moskopjimi, plagjiaturat e çdo forme etj). <i>[03_RVB_Financë; Aneksi 03 Rregullore e brendëshme e UMT; Aneksi 37 Rregullore e provimeve]</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në bazë të informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi, se pedagogët alternojnë metodat e vlerësimit të studentëve, nga testet e ndërmjetme, ku një pjesë e tij përbëhen prej pyetjeve me alternativave me rrethim apo me zhvillim, tek rastet studimore apo tek prezantimet në grupe ose individuale. Teza hartohet me nivele vështirësie për të krijuar mundësi të gjithë studentëve të zhvillojnë pjesë të tezës dhe të vlerësohen sipas meritës e rezultateve të arritura prej tyre. Në rregullore paraqitet edhe koha e korrigjimit dhe shpalljes së rezultateve të provimit. Mbas përfundimit të provimit teza dhe zgjidhja përkatëse depozitohen në departament. <i>[03_RVB_Financë; Aneksi 37 Rregullore e provimeve]</i>

Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se institucioni respekton e garanton të drejtat e studentëve. Studentët e programit të studimit, vlerësohen në përputhje me arritjet e tyre në të gjithë elementët përbërës të vlerësimit, të parashikuara në rregulloren e Fakultetit, në rregulloren e programit të studimit, në rregulloren e provimeve si edhe në syllabusin e lëndës. Provimi i lëndës zhvillohet me sekretim. Sekretimi fletoreve është përgjegjësi e përgjegjësit të departamentit. Sekretimi bëhet në prani të komisionit të provimit. Rezultatet jepen në kohën e duhur, sipas informimit që u është bërë studentëve për shpalljen e rezultateve. Në këto rregullore parashikohet e drejta e studentëve për të kërkuar rishikim të provimit, apo ballafaqim me rezultatet e provimeve, nëse nuk janë të bindur për vlerësimin. Në raste kur ka ankesa edhe pas ballafaqimit të rezultateve të provimeve nga ana e lektorit me studentët, ngrihet komision tjetër provimi nga ana e përgjegjësit të njësisë bazë për të rivlerësuar rezultatin, pas kërkesës së drejtuar nga studenti pranë sekretarisë mësimore, në zbatim të rregullores së Fakultetit Ekonomisë. <i>[Aneksi 11 Rregullore e FE në UMT; Aneksi 14 Rregullore e programit të studimit]</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet me anë të vlerësimit të vazhdueshëm përgjatë vitit. - Institucioni ka zbatuar projekte pilot për testimin përmes sistemeve elektronike, të cilat rrisin transparencën e vlerësimit. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. - Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se programi i studimit zhvillohet në funksion të marrjes së njohurive të specializuara në fusha të tilla siç janë Financa, Kontabiliteti dhe Bankingu, në përputhje me KSHK (Korniza Shqiptare e Kualifikimit, Niveli 6), pasi ofron njohuri teorike, praktike dhe profesionale. Ky program ka synim zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale të studentëve. Konkretisht gjatë procesit të mësimdhënies zbaton metoda mësimdhënie me studentët si: raste studimi, detyra në klasë, detyra në shtëpi ose detyra kursi në mënyrë individuale dhe në grup. Ndërsa, një rol kyç për zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve ka praktika mësimore, e cila zhvillohet në njesitë ekonomike, institucionet, bankat, apo në tërësi në subjektet, që kryejnë aktivitetin e tyre në përputhje me programin e studimit që ofron UMT. Praktikant mësimore i japin mundësi studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale, të aplikojnë njohuritë e marra gjatë zhvillimit të programit të studimit e t'i venë ato në jetë. <i>[Aneksi 15 Dosja e programit të studimit]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Referuar planit mësimor të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë” me profile: “Kontabilitet” dhe “Bankë”, konstatohet se nëpërmjet lëndëve përkatëse (informatikë; sisteme kompjuterike kontabiliteti, shkrim akademik, etikë biznesi etj), sigurohet nga institucioni, zhvillimi i aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. <i>[Aneksi 25 Plani mësimor i programit të studimit-Tabela 10]</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se syllabuset e lëndëve që zhvillohen, rishikohen dhe analizohen në fund të semestrit/vitit akademik mbas përfundimit të lëndës, me qëllim pasurimin me të rejtat më të fundit. Kjo analizë e syllabuseve, kryhet jo vetëm në referencë të eksperiencës ndërkombëtare dhe kombëtare, por dhe me suksesin dhe problemet e shfaqura gjatë zbatimit të syllabusit gjatë vitit akademik. Nga grupet mësimore në departament, diskutohen çështje të ndryshme për përmirësimin në vazhdimësi të procesit mësimor dhe të syllabuseve si dhe çështje të veçanta që kanë të bëjnë me përmirësimin në vazhdimësi të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.



	<i>[Aneksi Nr.27, Plan-programi/Syllabuset e lëndëve; Aneksi Nr.37, Rregullore e Provimeve]</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Referuar RVB, evidencave përkatëse në mbështetje të RVB, si dhe takimeve në institucion gjatë vizitave në institucion, GVJ konstaton se ngarkesa mësimore në auditor sipas lëndëve (pjesa teorike), si dhe rezultatet e pritshme për studentin (referuar syllabuseve) u jep mundësi studentëve që të zhvillojnë njohuritë praktike të tyre gjatë zhvillimit të praktikës profesionale. Studentët inkurajohen për të punuar në grup edhe në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë apo të kursit dhe gjatë procesit mësimor ku secili është pjesë e një popullimi që i përket ose klientit ose shitësit apo një aktori tjetër. Puna në grup e studentëve (detyra kursi, raste studimi etj) gjatë procesit mësimor të zhvillimit të lëndës, konsiderohet element i rëndësishëm i procesit mësimor sidomos në këtë program studimi, i cili kushtëzohet nga roli i aktorëve të ndryshëm në ekonomi. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogëve, në zbatim dhe të strategjisë të zhvillimit të UMT-së, ku procesi mësimor zhvillohet me në qendër studentin, janë shumë miqësor dhe komunikojnë mjaft mirë me studentët duke bërë që procesi mësimor të zhvillohet në mënyrë të natyrshme dhe pa sforcime. I gjithë ky proces monitorohet, ku një nga mënyrat është edhe pyetësori që bëhet në fund të lëndës me studentët. <i>[Aneksi Nr.36, Raport i Drejtorise së komunikimit për studentët 2017-2023; Aneksi Nr.20, Lista e marrëveshjeve në kuader të programeve të FE; Aneksi nr.3 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm në Bsc Financë me dy profile]</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Referuar RVB, takimeve në institucion, si dhe aneksit nr 39, GVJ konstaton se janë zhvilluar seminare dhe leksione të hapura me synim inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve në diskutime, proces përmes të cilit ata arrijnë të qartësojnë dhe krijojnë ide, të bëjnë aplikime të ndryshme, të formulojnë dhe realizojnë ide, projekte dhe qëllime të caktuara. <i>[Aneksi Nr.39, Lista aktiviteteve (leksione të hapura)]</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Programi i studimit garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve, garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.



	- <i>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</i> - <i>Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve të caktuara.</i> - <i>Personeli akademik ka zhvilluar seminare dhe leksione të hapura me synim inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve në diskutime.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Referuar RVB, evidencës në mbështetje të raportit (rregullores së provimeve) si dhe takimeve në institucion, GVJ vlerëson se institucioni ka akte rregullative specifike lidhur me provimet për lëndë ashtu dhe për provimin përfundimtar ku është përcaktuar dhe pragu i notës minimale (≥ 8) që i jep të drejtën studentit për punim diplome. <i>[Aneksi Nr.37, Rregullore e Provimeve] [Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit] [Aneksi Nr.49 Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës]</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Nga takimet në institucion, RVB dhe evidencat përkatëse, konstatojmë se janë strukturat përkatëse si departamenti i Financë Bankës, personeli akademik si dhe sekretaria mësimore që mbështesin studentët përmes seancave orientuese në auditorë, përmes sistemit edu4school, duke u dhënë informacione, udhëzime dhe materiale të ndryshme të nevojshme për realizimin e detyrimeve të tyre si gjatë vitit akademik edhe për detyrimet e tyre të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. <i>[Aneksi Nr.37, Rregullore e Provimeve; Aneksi Nr.40, Rregullore e Sekretarisë].</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit	Për studentët të cilët i nënshtrohen provimit final, nga komisionet përkatëse është hartuar fondi i pyetjeve ku përfshihen njohuritë e marra në tre vitet e studimit, dhe teza finale për studentët zgjidhet



final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	në mënyrë të rastësishme nga fondi i pyetjeve me sistem kompjuterik. <i>[Aneksi Nr.37, Rregullore e Provimeve; Aneksi Nr.40, Rregullore e Sekretarisë].</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Referuar akteve rregullative të UMT për hartimin dhe mbrojtjen e diplomës, si dhe nga takimet në institucion del qartë se studenti mbështetet nga stafi akademik i departamentit, udhëheqësi i diplomës dhe kordinatori i programit për përcaktimin e temës së diplomës. Pas miratimit të udhëheqësit të diplomës, është ky i fundit i cili asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. <i>[Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit; Aneksi Nr.49 Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës]</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Gjatë takimeve në institucion dhe evidencave të paraqitura prej tij, GVJ konstaton se është kordinatori i programit të studimit (personi përgjegjës për studentët i përcaktuar nga Dekani), si dhe personeli akademik i Departamentit të Financë Bankës i mbështet dhe orienton studentët për kryerjen e analizave të ndryshme në kuadër të temave që zhvillojnë ata si në mjediset e institucionit ashtu dhe jashtë institucionit. <i>[Aneksi 18, Vendim i Dekanit për emërimin e përgjegjësve të programeve të studimit dhe këshilltarëve akademikë në FE; Aneksi 17 Vendim i Senatit akademik mbi kompetencat dhe përgjegjësit e programeve dhe këshilltarëve akademikë të UMT]</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Referuar RVB, takimeve në institucion dhe vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstaton se në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. <i>[Aneksi Nr.37, Rregullore e Provimeve]</i>



Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Institucioni, në përfundim të studimeve i pajis studentët me diplomë dhe suplementin e diplomës, sipas ligjit 80/2015 për arsimin e lartë. Bazuar në legjislacionin në fuqi, modeli i diplomës dhe suplementi i saj, miratohen për herë të parë nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) sipas dispozitave ligjore në fuqi. Me përfundimin e studimeve, studentit përveç diplomës dhe suplementit të saj, me kërkesën e tij, i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. <i>[Aneksi Nr.41, Modeli i diplomës; Aneksi Nr.42 Suplement i diplomës]</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Referuar RVB dhe takimeve dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni UMT ruan sipas ligjit për arkivat, por edhe bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dokumentacionin për çdo student, dhe me kërkesë të studentit, jep informacionet e kërkuara. <i>[Aneksi Nr.40, Rregullore e Sekretarisë; Aneksi Nr.43, Rregullore e Arkivës]</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Institucioni ka akte rregullative specifike lidhur me provimet për lëndë ashtu dhe për provimin përfundimtar ku është përcaktuar dhe pragu i notës minimale që i jep të drejtën studentit për punim diplome.</i> - <i>Strukturat përkatëse si departamenti, personeli akademik si dhe sekretaria mësimore asistojnë studentët duke u vënë atyre në dispozicion informacione, udhëzime, në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</i> - <i>Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike.</i> - <i>Udhëheqësit e diplomës, mbështesin studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në përfundimin e punimit të diplomës, për të garantuar cilësinë.</i> - <i>Me përfundimin e studimeve, studentit përveç diplomës dhe suplementit, me kërkesën e tij, i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</i> - <i>Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV.BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në informacionin e paraqitur në raportin e vetëvlerësimit (RVB), dokumentacionin shoqërues të RVB-së, si dhe informacionin e marrë në takimet e realizuara gjatë vizitës në Universitetin Metropolitan të Tiranës (UMT), GVJ konstaton se institucioni mban të dhëna të plota mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UMT. Struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e këtyre të dhënave është zyra e Burimeve Njerëzore. Gjatë vizitës pranë kësaj zyre GVJ konstatoi se kjo zyrë mban të dhëna në formën e dosjeve personale (format letër) për të gjithë personelin me kohë të plotë ose me kontratë dhe bën përditësimin e tyre. Programi i studimit Bsc. në Bankë me profile a) Kontabilitet dhe b) Bankë ofrohet nga Departamenti Financë-Bankë, Fakulteti i Ekonomisë. Në këtë program studimi, referuar Aneksit 16, për mësimdhënie gjatë vitin akademik 2023-2024 janë të angazhuar 30 pedagogë: • 15 PAE, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 3 me titullin “Profesor i Asocuar”, 8 me gradën “Doktor” dhe 2 me Msc; • 15 PAK, nga të cilët 3 me titullin “Profesor”, 7 me titullin “Profesor i Asocuar”, 4 me gradën “Doktor” dhe 1 me Msc.

	Ky program studimi për vitin aktual akademik ka të angazhuat 50% PAE dhe 50% PAK. <i>Pavarësisht se GVJ vlerëson nivelin e kualifikimit dhe eksperiencën e PAK, përsëri duke konsideruar rëndësinë që ka PAE në ofrimin e një programi studimi, GVJ sugjeron që të rritet mbulimi i këtij programi mësimor me personel akademik efektiv, në krahasim me personelin akademik me kontratë. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht se raporti i stafit akademik PAE dhe PAK është 50% me 50%, ngarkesa mësimore që mbulon stafi akademik PAE është 72% (e detajuar në kriterin e mëposhtëm).</i> Ndërkohë edhe pse u kërkuan nga GVJ në grupin e dokumentave shtesë, lista e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, për vitet akademik 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023, ky dokument nuk u dorëzua. Ndërkohë është dorëzuar në dokumentat shtesë lista e personelit akademik të angazhuar pranë Departamentit Financë-Bankë, për tre vitet akademike të sipërpërmendur. Në departamentin Financë-Bankë, përgjegjës për këtë program studimi, për mësimdhënie gjatë vitin akademik 2021-2022 janë të angazhuar 20 pedagogë: • 7 PAE, nga të cilët 2 me titullin “Profesor i Asocuar”, 4 me gradën “Doktor” dhe 1 me Msc (doktorant në proces); • 13 PAK, nga të cilët 3 me titullin “Profesor”, 5 me titullin “Profesor i Asocuar”, 3 me gradën “Doktor” dhe 2 me Msc. Raporti në personelin akademik të angazhuar është: 35% PAE dhe 65% PAK. Në departamentin Financë-Bankë, përgjegjës për këtë program studimi, për mësimdhënie gjatë vitin akademik 2022-2023 janë të angazhuar 24 pedagogë: • 7 PAE, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asocuar”, 3 me gradën “Doktor” dhe 1 me Msc (doktorant në proces); • 17 PAK, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 7 me titullin “Profesor i Asocuar”, 5 me gradën “Doktor” dhe 3 me Msc. Raporti në personelin akademik të angazhuar është: 30% PAE dhe 70% PAK.
--	---



	Në departamentin Financë-Bankë, përgjegjës për këtë program studimi, për mësimdhënie gjatë vitin akademik 2023-2024 janë të angazhuar 25 pedagogë: • 7 PAE, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asocuar”, 3 me gradën “Doktor” dhe 1 me Msc; • 18 PAK, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 7 me titullin “Profesor i Asocuar”, 5 me gradën “Doktor” dhe 4 me Msc. Raporti në personelin akademik të angazhuar është: 28% PAE dhe 72% PAK, ndërkohë që raporti në ngarkesën për këtë program studimi për personelin akademik të angazhuar është: 72% PAE dhe 28% PAK. Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik, GVJ konstatoi se stafi i angazhuar në këtë program studimi përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit (PAE dhe PAK që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi ka titujt dhe gradat sipas legjislacionit në fuqi), si dhe ka fushë kërkimore në përputhje me natyrën dhe veçoritë e lëndëve të ofruara. Universiteti Metropolitan, ka të angazhuar një personel ndihmës akademik prej 32 anëtarësh. Ky staf ndihmon në përmbushjen e aktivitetit mësimor dhe kërkimor të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, që ofrojnë këtë program studimi. <i>[Aneksi Nr.16.Lista e stafit të angazhuar në programin e studimit.pdf; Aneksi Nr.28. Plani i ngarkesës së programit sipas stafit.pdf; Aneksi Nr.29 Lista e personelit ndihmës akademik dhe administrative.pdf;Dokumenta shtesë: 6-Anex 34 CV-te e personelit të programit.pdf; Dokumenta shtesë: 3.Stafi akademik i DFB 2021-2024.pdf]</i>										
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik efektiv në këtë program studimi është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, duke plotësuar kushtet e kërkuara nga Ligji i Arsimit të Lartë për të dhënë mësim në Institucionet e Arsimit të Lartë. Kurrikula e këtij program, përsa i përket ngarkesës mësimore mbulohet kryesisht me personel akademik efektiv. Ngarkesa mësimore e personelit akademik për vitin akademik 2023-2024 është si më poshtë: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2023-2024</td><td>1825</td><td>1315</td><td>510</td><td>72% / 28%</td></tr></table>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2023-2024	1825	1315	510	72% / 28%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)							
2023-2024	1825	1315	510	72% / 28%							



	<i>[Aneksi Nr.28 Plani i ngarkesës së programit sipas stafit.pdf; Dokumenta shitesë: 6-Anex 34 CV-te e personelit të programit.pdf]</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit Bachelor në “Financë” i ofruar nga Departamenti Financë-Bankë. Kontratat e punësimit pranë UMT dhe mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. GVJ konstaton se gjatë tre viteve të fundit akademike, të shqyrtuara për akreditim, ka një rritje të numrit të personelit akademik me kontratë të angazhuar në departamentin që mbulon këtë program studimi, kryesisht në funksion të rritjes së PAK me tituj e grada. Gjithashtu në këto tre vjet, pavarësisht se numri i PAE ka ngelur stabil, cilësia e titujve dhe gradave të PAE ka ardhur në rritje. Bazuar në këtë informacion, në përgjithësi PAE dhe PAK i angazhuar në këtë program studimi nuk ka ndryshuar shumë. Mbi 80% e stafit akademik është i angazhuar gjatë të tre viteve akademik, megjithatë vihet re një rritje e PAE dhe PAK me tituj e grada, në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit që mbulon departamenti Financë-Bankë. <i>[Dokumenta shitesë: 6-Anex 34 CV-te e personelit të programit.pdf; Dokumenta shitesë: 3.Stafi akademik i DFB 2021-2024.pdf]</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit, faqen web të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ konstaton se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UMT. Në statutin e UMT janë të përcaktuara procedurat që ndiqen në rekrutimin e personelit akademik (neni 60), si dhe ndihmës akademik (neni 61). Kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare web të universitetit dhe janë në përputhje me specifikat e programit të studimit. Rekrutimi i personelit, bëhet me konkurrim të hapur. Institucioni shpall konkursin për vend të lirë pune, pas kërkesës së Departamentit Financë-Bankë, bazuar në nevojat e këtij të fundit. Njësia bazë përcakton kriteret specifike në lidhje me nivelin e duhur të kualifikimit në përputhje me modulet ku planifikohet të anagazhohet kandidati për vendin e lirë të punës. Për realizimin e procesit të rekrutimit ngrihet një komision ad-hoc, i përbërë nga

	anëtarë përfaqësues të njësive bazë, një përfaqësues i Dekanatit dhe një përfaqësues i Rektorit. Mbështetur në rregulloren e UMT, neni 11, pjesë e komisionit ad hoc është gjithmonë edhe Administratori. Vlerësimi i kandidatit bëhet më pikë, duke i renditur në rendin zbritës. Kandidati i propozohet Rektorit, i cili merr edhe vendimin për emërimin e personelit akademik. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf;Aneksi Nr.3.Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.46 Model i njoftimit në faqen zyrtare, për vendet vakante dhe krit.pdf]</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ konstaton angazhimin e personelit ndihmës akademik në funksion të këtij programi studimi. Universiteti Metropolitan, ka të angazhuar personel ndihmës akademik prej 32 anëtarësh. Ky staf ndihmon në përmbushjen e aktivitetit mësimor dhe kërkimor të njësive kryesore dhe njësive bazë, që ofrojnë këtë program studimi. Ky staf, veçanërisht 1 staf IT dhe 1 staf mbështetës ndihmojnë në realizimin e orëve laboratorike, si dhe në mirëmbajtjen e mjediseve mësimore. Aktualisht në shërbim të këtij programi ka 3 laboratorë kompjuterikë ku mund të zhvillohen orët e laboratoreve të përfshira në kurrikulën e programit. <i>[Aneksi Nr.25 Plani mësimor i programit të studimit-Tabela 10.pdf; Aneksi Nr.29 Lista e personelit ndihmës akademik dhe administrative.pdf; Aneksi Nr.47 Ambjentet për Infrastrukturën FE-UMT.pdf]</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë gjatë vizitës në UMT, GVJ konkludon se struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Financë”, është Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë funksionon bazuar në Ligji Nr. 80, datë 22.07. 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe Rregulloren e UMT. Gjatë vizitës pranë kësaj strukture, GVJ konstatoi se zyra e Burimeve Njerëzore mban të dhëna në formën e dosjeve personale (format letër) për të gjithë personelin me kohë të plotë ose me kontratë dhe i përditëson ato rregullisht mbi bazë vjetore. Nga verifikimi me zgjedhje i dy dosjeve personale pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, përkatësisht një PAE dhe një PAK, GVJ konstatoi plotësinë e tyre. Përmbajtja e dosjes së personelit akademik: dokument identiteti, CV, diploma (bachelor, master, etj., si dhe listat e notave shoqëruese); dokumentin e titullit akademik, librezë pune dhe sig shoqërore dhe shëndetsore, kontratë individuale; raport mjekësor; dëshminë e penaltetit;

personelit ndihmës dhe administrativ.	certifikatë mbrojte e gjuhës së huaj, si edhe dokumenta të tjerë plotësues kryesisht të lidhura me kualifikime shkencore dhe akademike. <i>[Aneksi Nr.3.Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.45 Model kontrata e punes.pdf]</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UMT në nivel Institucional ka nënshkruar një numër të lartë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe në kuadër të realizimit të praktikës mësimore të studentëve dhe mundësisë për punësim të tyre. Programi i studimit Bachelor në “Financë” ka pjesë të programit mësimor realizimin e praktikës mësimore me kohëzgjatje 4 javë, gjatë semestrit të dytë (në fund të semestrit), të vitit të tretë akademik. Numri i vogël i studentëve që frekuentojnë këtë program studimi, nuk i krijon institucionit asnjë problem për realizimin e praktikave mësimore. Nëse studentët nuk sigurojnë vetë një Institucion për të zhvilluar praktikën mësimore, atëherë zyra e Karrierës dhe Alumni ua mundëson praktikën pranë një Institucioni me të cilin kanë lidhur marrëveshje. Studentët të këtij program studimi marrin informacion në lidhje me mundësitë për realizimin e praktikave mësimore, kryesisht nëpërmjet lajmërimeve në website-in e UMT, rrjeteve sociale, por edhe eventeve të tjera të organizuara si: panairi i punës, leksione të hapura, workshop-e, trajnime, programit të mentorimit me Alumni, etj. Departamenti Financë Bankë cakton një staf akademik përgjegjës për mbarëvajtjen e studentit gjatë praktikës mësimore. Gjithashtu në vendin ku zhvillohet praktika, studentit i caktohet një person mbikqyrës për realizimin me sukses të praktikës profesionale. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, është i angazhuar për të asistuar studentët që klasifikohen për të përgatitur punim diplome, në drejtimin dhe mbikëqyrjen e tyre gjatë gjithë periudhës së përgatitjes, në zbatim të nenit 28 të Rregullores së programit të studimit. <i>[Aneksi Nr.21 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në kuadrin e praktikave.pdf; Aneksi Nr.22 Programi i praktikës.pdf; Aneksi Nr.50 Model i procesverbalit të vlerësimit të praktikës.pdf; Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneksi Nr.49 Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës.pdf]</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave	Në Institucionin ku zhvillohet praktika, studentit i caktohet një person mbikqyrës për realizimin me sukses të praktikës profesionale, krahas përcaktimit nga Departamenti i Financë

profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Bankës i një stafi akademik që do të ndjekë studentin gjatë gjithë periudhës së realizimit të praktikës. Mbikqyrësi në institucionin e zhvillimit të praktikës në fund të këtij procesi realizon edhe një vlerësim mbi punën e studentit. Gjithashtu në fund të praktikës përpilohen dokumentat në përputhje me programin e praktikës profesionale. Si pedagogu mbikqyrës, ashtu edhe mbikqyrësi në Institucion angazhohen në rritjen e nivelit profesional të studentëve dhe në përfundim të praktikës bëjnë vlerësimin me pikë të studentëve. Në përfundim të praktikës mësimore, studenti vlerësohet me notë nga një komision i ngritur nga Departamenti përgjegjës për këtë program studimi. <i>[Aneksi Nr.22 Programi i praktikës.pdf; Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneksi Nr.50 Model i procesverbalit të vlerësimit të praktikës.pdf]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në këtë program studimi, plotësojnë kushtet e kërkuara nga Ligji i arsimit të Lartë për të dhënë mësim në IAL si dhe kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe profesional për natyrën dhe modulet e këtij programi.</i> - <i>Ngarkesa mësimore në këtë program studimi mbulohet kryesisht me PAE. Stafi i angazhuar në këtë program studimi është përgjithësisht i qëndrueshëm, referuar si PAE, ashtu edhe PAK.</i> - <i>Institucioni ndjek procedurat e duhura të rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës akademik, duke përcaktuar kritere specifike në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij program studimi. Të dhënat e stafit ruhen konform të gjitha detyrimeve ligjore, si dhe përditësohen rregullisht.</i> - <i>Institucioni ka nënshkruar një numër marrëveshje bashkëpunimi me institucioni publike dhe private. Zyra e karrierës dhe ALUMNI si dhe stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, mundësojnë zhvillimin e praktikës mësimore profesionale, duke u siguruar që mbikqyrësi në vendin e praktikës të angazhohet në rritjen e nivelit profesional të studentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar RVB, dokumentacionit shoqërues, si dhe vizitës në Institucion, UMT siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit Bachelor në “Financë” duke ofruar 2 godina përkatësisht me sipërfaqe 2.347m² dhe 2.490m². Këto godina janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. UMT ofron 6 laboratorë informatike dhe një sallë biblioteke. UMT-së i është shtuar Inovation Center (Metropolitan Inovation Center) e pozicionuar në Qytetin Studenti dhe që do të shërbejë për aktivitete dhe nisma që kanë në qendër teknologjinë e informacionit. Gjatë vizitës së ambjenteve ku zhvillojnë mësim studentët e këtij program studimi, u konstatua se sipërfaqja e klasave është e përshtatshme për numrin aktual të studentëve. Klasat janë të pajisura me kompjuter, videoprojektor dhe mjete të tjera të domosdoshme për të realizuar procesin mësimor dhe një mësimdhënie sa më cilësore. Studentët konfirmuan që leksionet dhe prezantimet e tjera zhvilloheshin duke përdorur mjete audiovizive të cilat disponoheshin nga pedagogu i departamentit përkatës përgjegjës për mbulimin e lëndës. Në dispozicion të këtij program studimi janë 3 nga 6 laboratorë informatike që ka Institucioni të pajisur me nga një kompjuter për çdo student. <i>[Aneksi Nr.47 Ambjentet për Infrastrukturën FE-UMT.pdf]</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, RVJ konstatoi që mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë së lartë. Sallat ku zhvillohet mësimi janë të pajisur me PC dhe projektor, ndërkohë që laboratorët janë të pajisur me kompjutera, duke ju lehtësuar pedagogëve dhe studentëve procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në laboratorin ku zhvillohet lënda e informatikës janë të instalur programe të ndryshme në funksion të përmbushjes së programit të lëndës, ndërkohë në laboratorin që përdoret për lëndët profesionale është i instaluar programi kontabël Alpha. Në takimin me studentë u evidentua mundësia e përdorimit të sallave të laboratorëve për realizimin e punëve në grup, detyrave të kursit, si edhe gjatë procesit të realizimit të diplomës. <i>[Aneksi Nr.47 Ambjentet për Infrastrukturën FE-UMT.pdf]</i>

mësimdhënies-mësimnxënies.				
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë së lartë. Sallat ku zhvillohet mësim janë të pajisur me PC dhe projektor. Në laboratorin ku zhvillohet lënda e informatikës janë të instalur programe të ndryshme në funksion të përmbushjes së programit të lëndës, ndërkohë në laboratorin që përdoret për lëndët profesionale është i instaluar programi kontabël Alpha, të cilët ndihmojnë në aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve, duke plotësuar edhe objektivat kryesore të këtij program studimi. <i>[Aneksi Nr.47 Ambjentet për Infrastrukturën FE-UMT.pdf]</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UMT ofron 6 laboratorë informatike, si dhe një Inovation Center (Metropolitan Inovation Center). Gjithashtu laboratorët janë të pajisur me kompjuter, videoprojektor dhe mjete të tjera të domosdoshme për të realizuar procesin mësimor dhe një mësimdhënie sa më cilësore. Në laboratorin ku zhvillohet lënda e informatikës janë të instalur programe të ndryshme në funksion të përmbushjes së programit të lëndës, ndërkohë në laboratorin që përdoret për lëndët profesionale është i instaluar programi kontabël Alpha, të cilët ndihmojnë në aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve, duke plotësuar edhe objektivat kryesore të këtij program studimi. <i>[Aneksi Nr.47 Ambjentet për Infrastrukturën FE-UMT.pdf]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Institucioni ofron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e këtij program studimi.</i> - <i>Mjediset mësimore janë të pajisur me mjete të teknologjisë së lartë në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë program.</i> - <i>Laboratorët mësimorë janë të pajisur me programe dhe software të nevojshëm dhe të përshtatshme për aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve.</i> - <i>UMT ka hapur edhe një Inovation Center (Metropolitan Inovation Center) që do të shërbejë për aktivitete dhe nisma që kanë në qendër teknologjinë e informacionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Referuar dokumentave shoqëruese të RVB, GVJ konstatoi që për të gjitha lëndët e këtij programi vihet në dispozicion të studentëve literaturë bazë në gjuhën e programit dhe/ose në gjuhë të huaj, si dhe literaturë ndihmëse në gjuhën e programit dhe në gjuhë të huaj. GVJ-ja konstatoi se UMT-ja vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar pranë këtij universiteti bibliotekën, e cila ndodhet në katin e parë të godinës 1. Studentëve u ofrohet mundësia e shfrytëzimit të bibliotekës si paradite, ashtu edhe mbasdite. Në periudha të ngarkuara, ofrohet shërbim edhe ditën e shtunë. Nga vizita në bibliotekë rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, revista dhe botime të institucioneve të tjera; e cila mund të shfrytëzohet njëloj nga të gjithë studentët dhe stafi i universitetit, megjithatë kjo literaturë edhe pse është zgjeruar në krahasim me listën e titujve në akreditimin paraardhës, përsëri është e kufizuar dhe e vogël në numër. Ndërkohë që Institucioni nuk ofron akses për bibliotekë online për studentët, por kryesisht përdor aksesin që kanë në këto biblioteka staf akademik që ndjekin programe doktorature apo programe kërkimi pranë Universiteteve të huaja. <i>GVJ sugjeron shtimin e titujve fizikë në bibliotekë, si dhe regjistrimin në biblioteka prestigjoze online.</i> <i>[Aneksi Nr.54 Inventari i teksteve që disponon FE në bibliotekën e UMT.pdf; Aneksi Nr.53 Rregullore e bibliotekës - UMT.pdf]</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se literatura bazë, përditësohet rregullisht me botime të viteve të fundit. GVJ konstanton se ky përditësim nuk bëhet rregullisht për literaturën ndihmëse. Në bibliotekë numri i librave fizikë që shërbejnë si literaturë ndihmëse është relativisht i kufizuar dhe kryesisht me vite të hershme botimi. Ndërkohë që Institucioni nuk ofron akses për bibliotekë online për studentët, por kryesisht materialet sigurohen nga aksesin që kanë në këto biblioteka online stafi akademik që ndjek programe doktorature apo programe kërkimi pranë Universiteteve të huaja.

	<i>GVJ sugjeron shtimin e titujve fizikë në bibliotekë, si dhe regjistrimin në biblioteka prestigjoze online.</i> <i>[Aneksi Nr.54 Inventari i teksteve që disponon FE në bibliotekën e UMT.pdf; Aneksi Nr.53 Rregullore e bibliotekës - UMT.pdf]</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UMT vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar në këtë program studimi bibliotekën e cila ndodhet në katin e parë të Godinës 1. Me kërkesë të studentëve, apo në periudha të ngarkuara, shërbimi i bibliotekës ofrohet edhe ditën e shtunë. <i>[Aneksi Nr.53 Rregullore e bibliotekës - UMT.pdf]</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Nga vizita në këtë bibliotekë dhe informacioni i marrë nga dokumentat shoqërues të RVB-së, rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj; botime e monografi; e cila mund të shfrytëzohet njëllë nga të gjithë studentët dhe stafi i universitetit. Megjithatë kjo literaturë është e kufizuar dhe e vogël në numër. Numri i titujve fizik në bibliotekë është shtuar, krahasuar me gjetjet në akreditimin paraardhës të këtij program studimi, por <i>GVJ sugjeron që në literaturën e bibliotekës, nevojitet investim i mëtjetshëm.</i> <i>[Aneksi Nr.53 Rregullore e bibliotekës - UMT.pdf]</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni nuk ofron akses për bibliotekë online për studentët, por kryesisht materialet sigurohen nga aksesit që kanë në këto biblioteka online stafi akademik që ndjek programe doktorature apo programe kërkimi pranë Universiteteve të huaja. <i>GVJ sugjeron regjistrimin në biblioteka prestigjoze online.</i> <i>[Aneksi Nr.53 Rregullore e bibliotekës - UMT.pdf]</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike,	GVJ vizitoi ambjentet e Bibliotekës në godinën 1, që i shërben Institucionit, ku ka të ndarë pavionin për Fakultetin e Ekonomisë. Salla e bibliotekës ka internet dhe është e pajisur me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në katalogun e bibliotekës ku janë të regjistruar të gjithë titujt që



që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	ndodhen fizikisht në bibliotekë. GVJ-së iu konfirmua nga punonjësi i bibliotekës, si dhe studentët në takimin me ta, se biblioteka frekuentohej vazhdimisht nga studentët jo vetëm për të tërhequr libra apo materiale mësimore, për të punuar për detyra kursi, punim diplome, por edhe si sallë studimi. [Aneksi Nr.53 Rregullore e bibliotekës – UMT.pdf]
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ofron shërbimet për studentët në orare që përshtaten me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, për këtë program studimi. Për tu ardhur në ndihmë studentëve, me kërkesë të studentëve, apo në periudha me ngarkesë (sezon provime, summer school) biblioteka ofron shërbim edhe në fundjavë- ditën e shtunë. [Aneksi Nr.53 Rregullore e bibliotekës - UMT.pdf]
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Referuar RVB, dhe dokumentacionit shoqërues GVJ konston se në fillim të çdo viti pedagogët e angazhuar në këtë program studimi bëjnë kërkesa për blerje literature fizike për bibliotekën. Në Plan veprimin dhe objektivat për 2023-2024, Fakulteti i Ekonomisë, ka të përcaktuar edhe “monitorim i nevojave për tekste mësimore/ leksione të lëndëve të ndryshme”. Megjithatë në buxhetin e Institucionit nuk janë të evidentuar veçan shpenzimet që janë kryer për investimet në literaturën e bibliotekës, por nga dokumentat shoqërues dhe gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që kryesisht blihet literaturë kryesore që ofrohet për modulin/lëndën. GVJ sugjeron që në kuadër të objektivave të Fakultetit të Ekonomisë të pasurohet biblioteka me tituj fizikë të përditësuar në shqip dhe gjuhë të huaj, si dhe të vihet një fokus themelor në regjistrimin në biblioteka online për një akses më komod dhe me shumë përfitim për studentët. [Aneksi Nr.53 Rregullore e bibliotekës - UMT.pdf; Aneksi Nr.55 Plan veprimi dhe objektivat e FE për vitin akademik 2023-2024.pdf; Aneksi Nr.58 Buxheti i UMT.pdf]
Konkluzione	GVJ konstaton se:

	- Institucioni vë në dispozicion të studentëve literaturë bazë në gjuhën e programit dhe në gjuhë të huaj, si dhe literaturë ndihmëse në gjuhën e programit dhe në gjuhë të huaj për të gjitha lëndët/modulet e kurrikulës. - Biblioteka fizike vihet në dispozicion të të gjithë studentëve në mënyrë të barabartë, pa pagësë dhe në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor për këtë program studimi. Institucioni ka mundur në periudha të caktuara, edhe ofrimin e këtij shërbimi edhe në fundjavë-ditën e shtunë. - Salla e bibliotekës ka internet dhe është e pajisur me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në katalogun e bibliotekës ku janë të regjistruar të gjithë titujt që ndodhen fizikisht në bibliotekë. - Përditësimi i literaturës bazë bëhet rregullisht në syllabuset e lëndëve dhe në bibliotekën fizike. Ndërkohë ky përditësim është i kufizuar për literaturën ndihmëse. - Institucioni nuk ofron akses për bibliotekë online për studentët, por kryesisht materialet sigurohen nga aksesit që kanë në këto biblioteka online stafi akademik që ndjek programe doktorature apo programe kërkimi pranë Universiteteve të huaja. GVJ sugjeron shtimin e titujve fizikë në bibliotekë, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, si dhe të vihet thelbi në regjistrimin në biblioteka online për një akses më komod dhe me shumë përfitim për studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se përdoret Sistemi i kompjuterizuar “edu4school”, që është në funksion nga fillimi i vitit akademik 2019-2020. Ky sistem kompjuterik administrojnë informacionin për studentët që nga regjistrimi i tyre deri në mbylljen e programit të studimit. Informacioni për studentët konsiston kryesisht në të dhëna personale dhe vlerësime me nota. Ndërkohë sekretaria mësimore është struktura që administrojnë të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi. Gjatë

	vizitës në sekretari GVJ-ja verifikoi me zgjedhje dosjen e plotë të dy studentëve të programit të studimit Bachelor në “Financë” dhe përdorimin e regjistrave përkatës dhe konstatoi qe përdorimin e tyre sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. <i>[Aneksi Nr.52 Manuale përdorimi të Sistemit informatik te studenteve.pdf; Aneksi Nr.40 Rregullore e Sekretarisë.pdf]</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, Rregullores së UMT-së dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se personeli akademik dhe ndihmës akademik kanë akses në sistemin e menaxhimit të brendshëm, duke ofruar të gjithë informacionin e nevojshëm në kuadër të përmbushjes së objektivave të programit të studimit. Gjithashtu personeli akademik, personeli joakademik, si edhe studentët përdorin adresa të emailit me domain umt.edu.al, duke lehtësuar procesin e komunikimit ndërmjet tyre, si dhe aksesin në platformën “edu4school”. Ndërkohë administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Financë” realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore në formën e dosjes personale të personelit, si dhe departamenti Financë Bankë përgjegjës për këtë program studimi, në formën e dosjes së kërkimit shkencor. <i>[Aneksi Nr.52 Manuale përdorimi të Sistemit informatik te studenteve.pdf; Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneksi Nr.11 Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.3.Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.40 Rregullore e Sekretarisë.pdf]</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e dërguar nga Institucioni dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UMT, GVJ-ja konstatoi se platforma “edu4school” është e organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë. Aktualisht shkëmbimet e informacionit ndërmjet përdoruesve të platformës përqëndrohen kryesisht në përdorimin e platformës për konsultimin e informacioneve apo dokumenteve si syllabuset e çdo lënde, materialet e ofruara nga pedagogët e lëndës, frekuentimi i studentëve, vlerësimi i vazhduar, listat e notave dhe kreditet. Komunikimi (personel akademik, studentë, personel joakademik) realizohet edhe nëpërmjet adresave elektronike të emailit me domain umt.edu.al. Komunikimi ndërmjet rrjeteve sociale është një formë tjetër interaktive në funksion të lehtësimit të këtij program studimi. <i>[Aneksi Nr.52 Manuale përdorimi të Sistemit informatik te studenteve.pdf; Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të</i>



	<i>studimit.pdf; Aneksi Nr.11 Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.3. Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.40 Rregullore e Sekretarisë.pdf]</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ-ja konstaton se platforma “edu4school” është e organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë. Përdorimi i platformave online edu4school dhe gotomeeting, nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi ofron mundësi më të mëdha për një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, ofrim materiale, si dhe realizimin e Quizz-ve, Assignments në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>[Aneksi Nr.52 Manuale përdorimi të Sistemit informatik të studenteve.pdf; Aneksi Nr.14. Rregullore e programit të studimit.pdf]</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Aktet rregullatore të institucionit sigurojnë monitorimin e aktivitetit akademik e administrativ. Aktiviteti mësimor monitorohet nëpërmjet rregjistrimit mësimor i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga pedagogu i lëndës. Aktiviteti i sekretarisë mësimore mbikqyret nga Zv/dekani dhe realizohet në bazë të rregullores së fakultetit dhe rregullores së sekretarisë mësimore. GVJ konstaton se në tërësi sistemi i menaxhimit të UMT bëhet në mënyrë të dokumentar duke respektuar aktet rregullatore të institucionit dhe garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse. <i>[Aneksi Nr.3. Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.11 Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.40 Rregullore e Sekretarisë.pdf; Rregullore-UAMD-pdf]</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Pas konsultimit të website të UMT, GVJ konstatoi se janë bërë publike informacione që lidhen me programin e studimit, njësinë bazë që ofron programin e studimit, stafin akademik, si dhe një sërë informacionesh dhe aktivitetesh të tjera publikohen në faqen e internetit në gjuhën shqip, si edhe në gjuhë të huaj- anglisht. GVJ konstaton që informacioni në faqen e web-it është lehtësisht i aksesueshëm. <i>[Referenca: www.umt.edu.al]</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Institucioni disponon sistem menaxhimi efektiv nëpërmjet të cilit administron informacionin që lidhet me studentët dhe</i>

	aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. - Sistemi i menaxhimit ka të integruar dy platforma: "edu4school" dhe "GoToMeeting", të cilat mundësojnë një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. - Informacioni në website e UMT-së publikohen në dy gjuhë-shqip dhe anglisht, si dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe qëndrueshmërinë e programit të studimit. GVJ mbështetur në dokumentat shoqëruese të RVB dhe vizitën në institucion konstatoi se UMT harton planin financiar të të ardhurave dhe kostove për njësitë bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron ky institucion, si dhe në terma të përgjithshëm për programin e studimit. Çdo njësi bazë përgatit projekt buxhetin bazuar në nevojat për mbulimin e programeve të studimit që ofron. Bazuar në këto projektbuxhete hartohet projekt buxheti për institucionin, në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit të tij. [Aneksi Nr.58 Buxheti i UMT.pdf; Aneksi Nr.59 Raport Auditues Pasqyrat Financiare 2022.pdf; Aneksi Nr.57 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në UMT në 6 vitet e fund.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf]
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve,	Projektbuxheti i vitit pasardhës hartohet në përputhje me propozimet e bëra prej njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Në raportet financiare të shpenzimeve janë të detajuara me zërat përkatës të mbulimit të pagesës së orëve të mësimi për personelin akademik efektiv dhe personelin akademik me kontratë, personelin jo akademik, mirëmbajtjen e ambjentëve dhe klasave, shpenzimet për bibliotekën, grantet vendase dhe të huaja (kryesisht nëpërmjet projekteve).



shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Në analizën financiare të institucionit janë të detajuar pjesa e shpenzimeve dhe të ardhurave, në zëra bruto për Fakultetin e Ekonomisë, që ka pjesë të tij edhe Departamentin Financë-Bankë që është përgjegjës edhe për këtë program studimi. Senati akademik është institucioni që bën miratimin e projektbuxhetit në përputhje me përmbushjen e objektivave të Institucionit në kuadër të procesit mësimor dhe kërkimor. Ndërkohë GVJ konstatoi se UMT vazhdon të investojë në infrastrukturë, rritjen e numrit të laboratorëve (në 6), si dhe krijimin e Inovation Center që ka në fokus aktivitete dhe nisma në fushën e teknologjisë dhe informacionit. <i>[Aneksi Nr.58 Buxheti i UMT.pdf; Aneksi Nr.59 Raport Auditues Pasqyrat Financiare 2022.pdf; Aneksi Nr.57 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në UMT në 6 vitet e fund.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf]</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ mbështetur në RVB si dhe në dokumentacionin shoqërues konstatoi se Institucioni kryen auditim ligjor të përvitshëm nga audituesi ligjor Alb Auditing & Co. Ky auditues çdo vit harton një raport në lidhje me transparencën financiare të institucionit, duke analizuar edhe të ardhurat dhe kostot për studentët. Audituesi ligjor i pavarur ofron opinion lidhur me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standartet kontabël. <i>[Aneksi Nr.59 Raport Auditues Pasqyrat Financiare 2022.pdf]</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ mbështetur në dokumentat shoqëruese të RVB dhe vizitën në institucion konstatoi se UMT harton planin financiar të kostove të njësive bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron ky institucion. Çdo njësi bazë përgatit projekt buxhetin bazuar në nevojat për mbulimin e programeve të studimit që ofron. Bazuar në këto projektbuxhete hartohet projekt buxheti për institucionin, në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit të tij. Gjithashtu konstatohet që në rang njësie kryesore, bëhet një analizë mbi aktivitetin financiar vjetor, pra për vitin paraardhës akademik, krahas analizës për aktivitetin mësimor dhe kërkimor. <i>[Aneksi Nr.57 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në UMT në 6 vitet e fund.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf]</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit	UMT harton planin financiar të të ardhurave dhe kostove të njësive bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron ky institucion. Në kuadër të qëndrueshmërisë financiare është hartuar një raport mbi të ardhurat dhe financimet e ndryshme të UMT në 6 vitet e



të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	fundit. Në këtë analizë si dhe në analizën mbi raportin vjetor të aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar, nuk evidentohen probleme financiare. Megjithatë <i>GVJ sugjeron kryerjen e një analize qëndrueshmërie financiare të detajuar për këtë program studimi, duke konsideruar rënien e numrit të studentëve:</i> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th><th>2020-2021</th><th>2021-2022</th><th>2022-2023</th><th>2023-2024</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td><i>Të regjistruar në Vit I</i></td><td>15</td><td>11</td><td>5</td><td>6</td></tr> </tbody> </table> <i>[Aneksi Nr.57 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në UMT në 6 vitet e fundit.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf]</i>					2020-2021	2021-2022	2022-2023	2023-2024	<i>Të regjistruar në Vit I</i>	15	11	5	6
	2020-2021	2021-2022	2022-2023	2023-2024										
<i>Të regjistruar në Vit I</i>	15	11	5	6										
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>UMT harton planin financiar të të ardhurave dhe kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron ky institucion. Plani financiar në terma të gjerë përgatitet edhe për çdo program studimi.</i> <i>Në kuadër të qëndrueshmërisë financiare është hartuar një raport mbi të ardhurat dhe financimet e ndryshme të UMT në 6 vitet e fundit, duke mos evidentuar probleme për cënim të qëndrueshmërisë financiare të Institucionit.</i> <i>UMT kryen auditim ligjor të përvitshëm nga audituesi ligjor Alb Auditing & Co, i cili harton një raport në lidhje me transparencën financiare të institucionit, si dhe ofron opinion lidhur me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standartet kontabël.</i> <i>GVJ sugjeron kryerjen e një analize qëndrueshmërie financiare të detajuar për këtë program studimi, duke konsideruar rënien e numrit të studentëve të regjistruar.</i>													
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht										
				X										

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




V.STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe konsultimit të faqes web të UMT, GVJ konstaton se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi Nr.3.Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.11 Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneksi Nr.5.DraftStrategjia 2022-2027-UMT.pdf]</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Barazia e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohej nga statuti i UMT, rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, dhe rregullore e Programit të studimit Bachelor në "Financë". Në rregulloren e programit të studimit është përcaktuar që pranohen në këtë program studimi kandidatët të cilët kanë mbaruar me sukses Maturën Shtetërore, sipas Udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara nga MASR. Pranë Fakultetit të Ekonomisë, ngrihet një komision ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve fitues bazuar në pikët e grumbulluara për këtë program studimi. Në këtë komision ad hoc janë të angazhuar edhe struktura e sistemeve informatike. Gjithashtu në njësinë bazë ngrihen edhe komisione për vendimet për transferime dhe ekuivalentim studimesh. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi Nr.3.Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.11 Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneksi Nr.68 Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në progra.pdf; Aneksi Nr.62 Kriteret e pranimi, vendime Senati.pdf; Aneksi Nr.67 Kuotat e pranimi 2021-2022, 2022-2023,2023-2024.pdf; Aneksi Nr.66 propozim kuotat e pranimi FE.pdf; Aneksi Nr.64 Proces-verbal pranimi-rankimi i maturantëve.pdf; Aneks Nr.70-Vendim rektori per pranimet.pdf]</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departmenti Financë-Bankë dhe Fakulteti i Ekonomisë, si njësi

akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	bazë dhe kryesore përgjegjëse për këtë program studimi përcakton kuotat e pranimi, kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për këtë cikël studimesh, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe standartet shtetërore të cilësisë. Parashikohen gjithashtu kuota për studentët e huaj (troje) dhe kategori të caktuara në përputhje me VKM përkatëse. <i>[Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneksi Nr.68 Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në progra.pdf; Aneksi Nr.62 Kriteret e pranimi, vendime Senati.pdf; Aneksi Nr.67 Kuotat e pranimi 2021-2022, 2022-2023,2023-2024.pdf; Aneksi Nr.66 propozim kuotat e pranimi FE.pdf; Aneksi Nr.64 Proces-verbal pranimi-rankimi i maturantëve.pdf; Aneks Nr.70-Vendim rektori per pranimet.pdf]</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, si dhe konsultimit të faqes web të UMT, GVJ konstaton se Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme nga publiku: - Në sekretarinë mësimore të UMT; - Afishimit të informacionit në stenda në ambjentet ku zhvillon aktivitetin UMT; - Faqen web të UMT-së. <i>[Referenca: www.umat.edu.al; vizita në institucion]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Informimi i të gjithë të interesuarve në lidhje me UMT, programet e studimit dhe kriteret e pranimi në to, realizohet nëpërmjet fushatës sensibilizuese për tërheqjen e kandidatëve për studentë në këtë program studimi. Zakonisht kjo fushatë konsiston në takimet e programuara me maturantë në gjimnaze publike dhe private në vend. Këto takime programohen dhe realizohen në rang Institucioni, kryesisht nga sektori i marketingut pranë UMT, si dhe Fakulteti i Ekonomisë, në periudhat e përcaktuara nga MAS. Mbahet parasysh që i gjithë informacioni që ofrohet gjatë fushatës sensibilizuese të jetë i publikuar në faqen web të UMT. <i>[Aneksi Nr.62 Kriteret e pranimi, vendime Senati.pdf; Aneksi Nr.68 Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në progra.pdf; www.umat.edu.al]</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon	GVJ konstaton se në Evidencën 66- Propozim kuotat e pranimi FE, Dekani i Fakultetit të Ekonomisë i propozon Rektoratit të

përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UMT-së, kuotat për programet e studimit që mbulon, ku janë përcaktuar specifikisht kuota për persona me nevoja të veçanta, me statusin jetim, shtresa të marginalizuara, të huaj, si dhe shqiptarë të trojeve. Gjatë vizitës në Institucion, në takimin me studentë, u konfirmua ndjekja e këtij program studimi nga studentë me nevoja të veçanta, si dhe mbështetjen me bursë për studime nga UMT. <i>[Aneksi Nr.66 propozim kuotat e pranimi FE.pdf]</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konstanton se në rregulloren e këtij program studimi (neni 17) është i parashikuar që kanë të drejtë të pranohen në këtë program studimi edhe kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj; si edhe shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe. Kriteret dhe rregullat për përzgjedhje edhe në këtë rast përcaktohen nga një komision ad-hoc që ngrihet nga njësia bazë. <i>[Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneksi Nr.66 propozim kuotat e pranimi FE.pdf]</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Referuar RVB, institucioni zbaton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë, si dhe personave me aftësi të veçanta. Gjatë vizitës në Institucion, në takimin me studentë, u konfirmua ndjekja e këtij program studimi nga student me nevoja të veçanta, si dhe mbështetjen me bursë për studime nga UMT. GVJ konstanton që UMT ka përgatitur një Rregullore për studentët e shkëlqyer. Në këtë rregullore përcaktohen kriteret për përfitimin e bursave të studimit nga UMT për student me mesatare të lartë të përfundimit të Maturës Shtetërore, si dhe kriteret për mundësinë e trajtimit me bursa në vazhdimësi, në varësi të rezultateve gjatë studimeve në nivelin Bachelor. Këto masa ndërmerren në kuadër të rritjes së cilësisë së pranimeve në këtë Institucion, si dhe cilësisë së këtij program studimi. Ky institucion bën publike në faqen web të institucionit kriteret dhe sqarime të tjera për përfituesit e bursave. <i>[Aneks Nr.89-Rregullore për studentët e shkëlqyer.pdf; Aneksi Nr.61 Guida e studentit.pdf; www.umat.edu.al]</i>
Konkluzione	GVJ konstanton se: - Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. - Institucioni publikon përpara fillimit të çdo viti akademik, kriteret dhe procedurat e pranimi në programin e studimit

	<i>duke garantuar akses në informacion dhe barazi në procesin e pranimit të aplikimeve dhe të përzgjedhjes për të gjithë kandidatët.</i> - <i>Institucioni përcakton kuota për persona me aftësi të veçanta, me status jetimi, grupeve të marginalizuara, shtetasit e huaj dhe trojet.</i> - <i>Institucioni ofron bursa për shtresa në nevojë, si dhe veçanërisht për aplikantë me mesatare të lartë, në kuadër të rritjes së cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UMT, GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Këto kritere dhe procedura janë pjesë e Rregullores së UMT (Kreu V, neni 43-48), dhe veçanërisht të Rregullores së programit të studimit (neni 24-28). Rregullore e UMT-së është e publikuar në faqen zyrtare web të institucionit. <i>[Aneksi Nr.3.Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf]</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Referuar Rregullores së ciklit të studimit dhe rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, RVJ konstatoi se studentit i ofrohet mundësia për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, si brenda institucionit ashtu edhe nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit (neni 21) për transferimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë (neni 45) dhe rregulloren e UMT (neni 49).

	Njësia bazë ngre një komision ad-hoc i cili merr vendimin për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet. Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore u kërkua dosja e një studenti të transferuar të zgjedhur nga GVJ në mënyrë rastësore dhe dosja rezultoi e plotë, si dhe ishin ndërmarrë të gjithë hapat e përmendur në rregulloret e sipërpërmendura gjatë procedurës së transferimit. <i>[Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneksi Nr.11Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.3.Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.15.Dosja e Programit të Studimit.pdf]</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konkludoi që studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit dhe Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë. Në orën e parë të fillimit të procesit mësimor për secilën lëndë, studentëve ju ofrohet informacion nga pedagogu për syllabusin e lëndës, detyrimeve për tu përmbushur si edhe mënyrën e vlerësimit. GVJ konstatoi se vlerësimi i vazhduar i dijeve të studentëve kryhet në mënyrë të njëjtë për të gjitha lëndët e kurrikulës së këtij programi dhe programeve të tjera të studimit, me vendim të Senatit Akademik si më poshtë: • Aktivizimi në auditor - 5 pikë • Frekuentimi - 5 pikë (i detajuar pikëzimi, në varësi të frekuentimit) • Test 1- 5 pikë • Test 2- 5 pikë • Provim i ndërmjetëm- 20 pikë nëse lënda nuk ka DK/ 10 pikë nëse ka të programuar DK • Detyra, projekte, etj. – 10 pikë; <i>GVJ sugjeron që të ketë më tepër lirshmëri në vlerësimin e vazhduar për personelin akademik, në respekt të lirisë akademike dhe të karakteristikave të lëndës. Realisht, nga takimet në Institucion me personelin akademik dhe studentët, doli që nuk ndiqej me përpikmëri skema e mësipërme.</i> <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneksi Nr.11Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.3.Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.15.Dosja e Programit të Studimit.pdf]</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë	Referuar RVB, rregullores së programit të studimit për detyrimet përmbyllëse dhe vizitës në institucion, GVJ konkludoi që studentët

informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	informohen mbi kriteret dhe procedurat e diplomimit për këtë program studimi. Procedura e mbrojtjes së diplomës është: - Me mbrojtje punim diplome. Rregullorja e programit të studimit ka të përcaktuar kriterin e notës mesatare (8 e lart) që studenti të ketë mundësinë e mbrojtjes me punim diplome. Tema e diplomës duhet të përkojë me fushat e kërkimit të departamentit. - Me provim diplome. Ky provim diplome bazohet në një bankë pyetjesh që përfshin nga Lëndë Kategoriuere të zhvilluara gjatë tre viteve të programit të studimit. Banka e pyetjeve përgatitet nga personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi dhe është përgjegjësi e Departamentit Financë Bankë. Punimi/ provimi i diplomës vlerësohen me notë, nga komisioni i ngritur nga njësia bazë. Referuar takimit me studentët gjatë vizitës në institucion, studentët ishin të mirëinformuar për mënyrën dhe procedurat e diplomimit, gjatë viteve të studimeve. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneksi Nr.11Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.3.Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.15.Dosja e Programit të Studimit.pdf]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë gjatë vizitës në institucion, si dhe në faqen web të UMT, GVJ konstatoi se Institucioni realizon aktivitete si: fushatë sensibilizuese me maturantë në shkolla publike dhe private, panairin e punës, afishim të informacionit në mjediset e UMT, komunikim në rrjetet sociale, si edhe publikim në faqen web të UMT për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi të gjitha programet e studimit. <i>[Dokumenta shtesë: 4-Raporti Alumni UMT 2023.pdf; www.umt.edu.al]</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre, transferimit të studimeve si dhe njohjes së kualifikimeve të mëparëshme në rast transferimi studimesh.</i> - <i>Institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit, dhe përmbylljes së tyre me punim diplome apo provim diplomimi.</i>



	- <i>Insitucioni realizon një numër aktivitete dhe ofron informacion duke informuar përpara fillimit të çdo viti akademik të interesuarit dhe studentët e ardhshëm për programet e studimit.</i> <i>GVJ duke konsideruar vendimin e senatit akademik, që vlerësimi i vazhduar të jetë i njëjtë për të gjitha lëndët, sugjeron që të ketë më tepër lirshmëri në vlerësimin e vazhduar, në respekt të lirisë akademike të personelit akademik dhe të karakteristikave të lëndës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Referuar RVB, vizitës në institucion, si dhe faqes web të UMT, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit Bachelor në “Financë” me profile: Kontabilitet dhe Bankë, informohen në fillim të vitit të parë akademik nga pedagogët që janë të angazhuar në këtë program studimi, si dhe sekretaria mësimore e Fakultetit të Ekonomisë për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi, si dhe i sqaron për çdo pyetje apo paqartësi që mund të kenë studentët. Informacioni ofrohet edhe në faqen web të UMT si edhe në rrjetet sociale, që administrohen nga njësia bazë, njësia kryesore dhe kryesisht në rang Institucioni. [Referenca: www.umat.edu.al]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët e këtij program studimi marrin informacionin më të detajuar për të gjithë elementët lidhur me modulet e kurrikulës së programit, gjatë prezantimit të orës së parë të mësimin nga pedagogët e lëndës. Informacion të detajuar studentët mund të gjejnë edhe në: sekretarinë mësimore, faqen web të UMT, afishimeve në ambjentet e Fakultetit të Ekonomisë (UMT), rrjeteve sociale, si edhe komunikimit me pedagogët e angazhuar në këtë program studimi si fizikisht, ashtu edhe virtualisht nëpërmjet platformave online. [Aneksi Nr.27.1 Syllabuset vitit parë semestri parë FK.pdf; Aneksi Nr.27.2 Syllabuset vitit parë semestri dytë FK.pdf; Aneksi Nr.27.3 Syllabuset vitit dytë semestri parë FK.pdf; Aneksi Nr.27.4 Syllabuset vitit parë semestri dytë FK.pdf; Aneksi Nr.27.5 Syllabuset vitit tretë semestri parë FK.pdf; Aneksi Nr.27.6 Syllabuset vitit tretë semestri dytë FK.pdf; www.umat.edu.al]

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Alumnit, Karrierës dhe Marketingut, gjatë vizitës në institucion, rezultoi se këto struktura kujdesen kryesisht për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit si dhe mundësitë për internship. Kjo zyrë ka në fokus ofrimin e trajnimeve për studentët për ti përgatitur për të aplikuar për punësim, si dhe organizon evente në funksion të punësimit. Panairi i punës, open day, “programi i mentorimit me Alumni”, janë aktivitetet që ndikojnë më tepër në punësimin e studentëve. Gjatë vizitës në institucion dhe veçanërisht gjatë takimit me studentë, doli në pah se informacion për punësim u ofrohej edhe nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi. <i>[Aneks Nr.76-Rregullore e zyrës se karrieres.pdf; Aneks Nr.90-Lista e stud. Alumni.pdf; www.umt.edu.al]</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstatoi se, pedagogët e departamentit Financë Bankë, në javën e parë të fillimit të studimeve, pedagogët e angazhuar në këtë program studimi në orën e parë të fillimit të lëndës së tyre, sekretaria mësimore, si dhe në mënyrë më të dedikuar Këshilltari akademik për programin e studimit, luajnë një rol kyç në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Faqja web e UMT si dhe rrjetet sociale luajnë gjithashtu një rol thelbësor në ofrimin dhe përditësimin e informacionit në lidhje me elementë të rëndësishëm të procesit mësimor. <i>[Aneksi Nr.18.VD për emrimin e përgjegjesve të programeve dhe këshilltarve ak.pdf; Aneksi Nr.17.VSA Komptentencat & përgjegjesit e P të programeve dhe këshillta.pdf; Aneks Nr.77-Dosje studenti.pdf; www.umt.edu.al]</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nëpërmjet faqes Web të UMT-së dhe hapësirës së dedikuar në platformën “edu4school”, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, të konsultojnë vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar sipas lëndëve që kanë frekuentuar, orarin e provimeve, etj, si dhe të informohen lidhur me infrastrukturën dhe aktivitete të tjera të organizuara në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe universiteti. <i>[Referenca: www.umt.edu.al]</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i>

	- Studentët informohen në fillim të vitit të parë akademik, si dhe gjatë gjithë periudhës së studimeve për të gjithë detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor si edhe elementët ndihmës në funksion të tij. - Zyra e Alumnit, Karrierës dhe Marketingut si dhe pedagogët e departamentit Financë Bankë, ofrojnë informacion për mundësitë e punësimit të studentëve, si dhe mundësitë për internship. Panairi i punës, open day, "programi i mentorimit me Alumni", janë aktivitetet që ndikojnë më tepër në punësimin e studentëve. - Studentët janë të përditësuar dhe kanë si akses fizik ashtu edhe online, në informacionin në lidhje me procesin mësimor, infrastrukturën, logjistikën dhe elementë të tjerë mbështetës të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Zyra e Alumnit, Karrierës dhe Marketingut pranë UMT janë njësi që kujdeset për mbajtjen e të dhënave dhe përpunimin statistikor vjetor për numrin e studentëve e të diplomuarve, në të gjithë programet e studimit të ofruar nga institucioni. Të dhënat për këtë drejtori ofrohen nga sekretaria mësimore e UMT. [Aneks Nr.77-Dosje studenti.pdf; Aneksi Nr.40 Rregullore e Sekretarisë.pdf; Aneks Nr.76-Rregullore e zyres së karrierës.pdf]
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga	Sekretaria mësimore e Fakultetit të Ekonomisë, pranë UMT mbledh, regjistron dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të tyre gjatë ciklit të studimeve dhe diplomimin e tyre. Regjistrat në sekretari (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i lëshimit të diplomave) janë të formatuar sipas standardeve shtetërore. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit Bachelor në "Financë" me profile dhe konstatoi plotësinë e tyre.

programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi janë: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Nr i të regjistruarve</th><th>Nr i të transferuarve</th><th>Nr Aktual</th><th>Nr i të diplomuarve</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>15</td><td>6</td><td>21</td><td>17</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>11</td><td>0</td><td>11</td><td>14</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>5</td><td>3</td><td>8</td><td>9</td></tr></table> <i>[Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; Aneksi Nr.40 Rregullore e Sekretarisë.pdf; vizita në institucion]</i>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të transferuarve	Nr Aktual	Nr i të diplomuarve	2020-2021	15	6	21	17	2021-2022	11	0	11	14	2022-2023	5	3	8	9
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të transferuarve	Nr Aktual	Nr i të diplomuarve																	
2020-2021	15	6	21	17																	
2021-2022	11	0	11	14																	
2022-2023	5	3	8	9																	
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UMT. Pranë sekretarisë mësimore informacioni ruhet në formatin letër (versioni hard copy) dhe në sistemin e menaxhimit informatik “edu4school” ruhet në versionin elektronik (soft copy). Të dy mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësit e çdo strukture të UMT-së, që merren me përpunimin e të dhënave personale bazohen në kriteret e përcaktuara në nenin 6 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe vecanërisht në nenin 105 të statutit të UMT. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi Nr.40 Rregullore e Sekretarisë.pdf; Aneksi Nr.43 Rregullore e Arkivës.pdf]</i>																				
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton	Referuar RVB, Statutit të UMT dhe Ligjit të Arsimit të Lartë (80/2015) njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit janë Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Alumnit, Karrierës dhe Marketingut. Institucioni ka hartuar rregulloret përkatëse për këto njësi, si dhe periodikisht ushtron kontroll nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Auditi i Jashtëm. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi Nr.40 Rregullore e Sekretarisë.pdf; Aneks Nr.76-Rregullore e zyres se karrieres.pdf; Aneksi Nr.11Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.59 Raport Auditues Pasqyrat Financiare 2022.pdf]</i>																				



gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.													
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti Financë Bankë analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për secilin program studimi. Një analizë për mesataren e studentëve bëhet edhe në fund të vitit të parë, për të parë performancën e tyre gjatë vitit të parë dhe për ta krahasuar me notën mesatare në hyrje. Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së fakultetit për vitin akademik, e cila mbyllet me problematikat dhe shoqërohet me rekomandime për përmirësime. <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Mesatarja në hyrje</th><th>Mesatarja në dalje</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>8,4</td><td>7,73</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>8,49</td><td>7,34</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>8,0</td><td>6,47</td></tr></table> Gjithashtu, zyra e Alumnit dhe Karrierës, mbledh informacion në lidhje me punësimin e të diplomuarve. Në raportin e Alumnit për vitin 2023, vihet re që pjesa më e madhe studentëve që ndjekin këtë program studimi janë të punësuar, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë tij (tabelat: Të dhënat për të diplomuarit në çdo program studimi të UMT, fq 31-39). [Dokumenta shtesë: 4-Raporti Alumni UMT 2023.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; Aneksi Nr.65 Cilësia në hyrje & dalje e studentëve.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; Aneksi Nr.32 Rezultatet e studenteve të viteve të para në UMT për vitin 2022.pdf]	Viti akademik	Mesatarja në hyrje	Mesatarja në dalje	2020-2021	8,4	7,73	2021-2022	8,49	7,34	2022-2023	8,0	6,47
Viti akademik	Mesatarja në hyrje	Mesatarja në dalje											
2020-2021	8,4	7,73											
2021-2022	8,49	7,34											
2022-2023	8,0	6,47											
Konkluzione	GVJ konstaton se: - UMT mban dhe disponon statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar, diplomuar dhe punësuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. - Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke siguruar respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.												

	- <i>Departamenti Financë Bankë përgjegjës për këtë program studimi, në bashkëpunim me zyrën e Alumni dhe Karrierës, analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, punësimin e tyre, duke nxjerrë rekomandimet në funksion të rritjes së cilësisë së programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezultojnë se UMT bazuar në Rregulloren e UMT (neni 18) si dhe Statutin e UMT (neni 103) u mundëson studentëve përfaqësim në organet e UMT-së, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Ata marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore. Gjithashtu rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë (neni 50) u mundëson studentëve përfaqësimin në organet e Fakultetit të Ekonomisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi Nr.3.Rregullore e Brendshme e UMT.pdf; Aneksi Nr.11Rregullore e FE në UMT.pdf]</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se aktualisht UMT përdor sistemin e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe stafit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve realizohet nga zyra e NjSBC dhe përfundon me hartimin e Raportit të NjSBC-së për procesin mësimor, i cili u komunikohet organeve drejtuese, individualisht secilit prej pedagogëve, dhe më pas përgjegjës të njësisë bazë dhe njësisë kryesore për të analizuar rezultatet dhe marrjen e masave përkatëse. Gjithashtu departamenti Financë Bankë, përgjegjës për këtë program studimi mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe kordinatorit të programit të studimit.

	<i>[Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.pdf; Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.pdf]</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Fakulteti i Ekonomisë dhe veçanërisht Departamenti Financë Bankë, përgjegjës për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet këshilltarit akademik të programit, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ndërkohë zyra e NJSBC-së përpunon të dhënat e pyetësorëve, për vlerësimin e procesit akademik dhe stafit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Ky feedback i jep mundësi reflektimi pedagogut të lëndës për problematika që mund të hasen, por edhe më gjerë pasi Përgjegjësi i Departamentit mund të kalojë për diskutim në mbledhje departamenti problematikave e ngritura duke marrë vendime përkatëse në hartim, rishikim dhe përmirësim programi. <i>[Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.pdf; Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf]</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë (neni 61-66) dhe Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në “Financë” me profile (neni 24-28), parashikon të drejtën e ankimimit, për të gjithë studentët lidhur me procesin dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, brenda 3 ditëve nga marrja e rezultatit të provimit, duke depozituar një kërkesë me shkrim pranë Departamentit Financë Bankë. Nëse edhe pas ballafaqimit me pedagogët e lëndës dhe tezën e provimit, studenti vazhdon të ketë pretendime për vlerësimin, atëherë ngrihet një komision shqyrtues nga Përgjegjësi i Departamentit që merr edhe vendimin përfundimtar për vlerësimin e tezës. Studentët janë në dijeni përpara se të hyjnë në provim për pikët e fituara nga vlerësimi i vazhduar, ndërkohë që pikët dhe nota e provimit ju komunikohet brenda 3 ditëve nga data e provimit. I gjithë ky informacion ju ofrohet edhe nëpërmjet platformës Edu4school. <i>[Aneksi Nr.11 Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf; Vizita në institucion- takimi me studentët]</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Rregulloret e Institucionit u mundësojnë studentëve përfaqësimin në organet e UMT, organet e Fakultetit të Ekonomisë me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

	- Studentët përfshihen në këshillim, sugjerim për rishikim dhe përmirësim të programit të studimit kryesisht bazuar në përpunimin e të dhënave të pyetësorëve nga NjSBC. - Studentët kanë të drejtën e ankimit për shkelje të rregullave gjatë zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin në provim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në Statutin dhe rregulloret e UMT, si dhe në rregulloren e programit të studimit përcaktohen procedurat dhe njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaria mësimore e Fakultetit të Ekonomisë e dedikuar për programin e studimit, këshilltari akademik i programit të studimit; zyra e shërbimit ndaj studentit si dhe zyra e Alumnit, Karrierës dhe Marketingut. [Aneksi Nr.11 Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.14 Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneksi Nr.40 Rregullore e Sekretarisë.pdf; Aneks Nr.76 Rregullore e zyrës së karrierës.pdf; Aneksi Nr.36 Raport i Drejtorisë së komunikimit për studentët 2017-2023.pdf]
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Departamenti Financë Bankë, që është edhe njësi bazë që mbulon këtë program studimi është përgjegjës për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve nëpërmjet njësive të sipërpërmendura, por edhe personelit akademik. Koordinator i programit të studimit, si dhe këshilltari akademik, luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Njësia kryesore, veçanërisht nëpërmjet zyrës së Marketingut, administron rrjetet sociale për të krijuar një kontakt më të afërt dhe miqësor me studentët, duke ofruar në këtë mënyrë informacion dhe këshilla që lidhen me programin e studimit. [Aneksi Nr.61 Guida e studentit.pdf; Aneks Nr.76 Rregullore e zyrës së karrierës.pdf; Aneksi Nr.55 Plan veprimi dhe objektivat e FE për vitin akademik 2023-2024.pdf; Aneksi Nr.17 VSA Kompetencat & përgjegjësit e P të programeve dhe këshillta.pdf]

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ konstaton se shërbimi i këshillimit të karrierës për studentët e UMT në rang Institucioni ofrohet nga zyra e Alumnit, Karrierës dhe Marketingut, si dhe zyra e shërbimit ndaj studentit. Ndërkohë në nivel program studimi konsulenca ofrohet nga Këshilltari akademik për Programin e studimit. Specialistët e këtyre zyrave këshillojnë studentët për të gjitha hallkat në përgatitjen për tregun e punës. Nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme si trajnime të ndryshme, panairin e punës, guest lectures, programi i mentorimit, evente të klubeve studentorë, përdorimin e faqes web të UMT, etj, synohet të rritet pjesëmarrja aktive, të promovohen studentët, si dhe të rriten mundësitë e punësimit të tyre. Studentëve u ofrohen mundësi për të realizuar praktika profesionale pranë një sërë institucionesh publike dhe private në vend, me të cilat UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. <i>[Aneks Nr.76-Rregullore e zyrës se karrieres.pdf; Aneksi Nr.61 Guida e studentit.pdf; Aneksi Nr.21 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në kuadrin e praktikave.pdf; Aneksi Nr.20.Lista e marrëveshjeve në kuader të programeve të FE.pdf; Aneksi Nr.39 Lista aktiviteteve (leksione te hapura).pdf; Aneksi Nr.36 Raport i Drejtorise së komunikimit për studentët 2017-2023.pdf]</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Alumnit, Karrierës dhe Marketingut ndjek studentët pas diplomimit në funksion të: - Mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave në lidhje me shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve; - Krijimi i rrjetit ALUMNI, për të ndikuar në rritjen e cilësisë së programit të studimit për të ardhmen. Të dhënat statistikore të përpunuara nga Zyra e Alumnit, Karrierës dhe Marketingut i dërgohen Përgjegjësit të Departamentit Financë-Bankë dhe Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, të cilat konsiderohen në analizën e punës vjetore të departamentit dhe në përmirësimin e cilësisë së këtij program studimi, dhe programeve të studimit që ofrohen nga ky departament. <i>[Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; Aneksi Nr.55 Plan veprimi dhe objektivat e FE për vitin akademik 2023-2024.pdf; Aneksi Nr.36 Raport i Drejtorise së komunikimit për studentët 2017-2023.pdf; Aneks Nr.90-Lista e stud. Alumni.pdf; Aneks Nr.76-Rregullore e zyrës se karrieres.pdf; Dokumenta shtesë: 4-Raporti Alumni UMT 2023.pdf; Dokumenta shtesë: 7-Te dhëna nga pyetësori Alumni.pdf]</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se:

	- Institucioni ka njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaria mësimore; këshilltari akademik i programit të studimit; zyra e Alumnit, Karrierës dhe Marketingut, si dhe zyra e shërbimit ndaj studentit. Njësia bazë që mbulon këtë program studimi është gjithashtu përgjegjëse për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve. - Specialistët e zyrës së Alumnit, Karrierës dhe Marketingut, zyrës së shërbimit ndaj studentit, si dhe Departamenti Financë Bankë u ofrojnë studentëve informacion dhe këshillim për procesin mësimor, praktika profesionale, si dhe orientim në tregun e punës. - Zyra e Alumnit, Karrierës dhe Marketingut ndjek studentët pas diplomimit, mbledh e përpunon të dhëna mbi cilësinë e punësimit të studentëve dhe ia dërgon Përgjegjësit të Departamentit Financë Bankë dhe Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, të cilat konsiderohen në analizën e punës vjetore të departamentit dhe në përmirësimin e cilësisë së këtij program studimi dhe programeve të studimit që ofrohen nga ky departament.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Institucioni ka në fokus të politikave dhe objektivave të tij zhvillimin e metodave inovative në mësimdhënie në funksion të rritjes së cilësisë së programeve të studimit. UMT harton periodikisht udhëzues në nivel institucional në shërbim të implementimit të misionit dhe vizionit të Universitetit. Strategjia e Zhvillimit të UMT, si dhe Draft Strategjia



mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	2022-2027 shërbejnë si udhëzues për përmbushjen e objektivit që të jetë një qendër tërheqëse për studentët duke ofruar programe që motivojnë të mësuarit përmes eksperiencës, bashkëpunim ndërdisiplinor dhe me prioritet ndërkombëtarizimin. <i>[Aneksi Nr.5.DraftStrategjia 2022-2027-UMT.pdf; Aneksi Nr.4.Strategjia e Zhvillimit të UMT.pdf]</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBC pranë UMT mbështetur në rregulloren për këtë njësi synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për të përmbushur standartet e cilësisë të përcaktuar nga UMT, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet: kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. Institucioni bën monitorim të vazhdueshëm dhe vlerësim periodik të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik, kryesisht nëpërmjet bashkëpunimit të strukturave të mëposhtme: - Zyra e Kurrikulës dhe Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë - Përgjegjësi i Departamentit Financë Bankë, përgjegjës për programin e studimit. NJSBC pranë UMT është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Mekanizmi kryesor që përdoret është Pyetëtori për studentët. Ky pyetësor përfshin vlerësimin për stafin akademik dhe për lëndët e kurrikulës së programit. Ai realizohet në fund të çdo semestri, përpara zhvillimit të provimeve të lëndës. Raportet e NJSBC (me bazë gjashtëmujori- pas cdo semestri) analizohen në mbledhjen e Departamentit Financë Bankë dhe merren vendimet përkatëse. Në fund të çdo viti akademik Departamenti Financë Bankë bën analizën e ecurisë së punës vjetore. <i>[Aneksi 82. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.pdf; Aneksi Nr.44 Model i formularit të vlerësimit të performancës.pdf; Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.pdf; Dokumenta shtesë_1.Raporti Vjetor 2022-2023-DFB.pdf]</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Funksionimi dhe organizimi i Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bazohet në statutin e UMT.



vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Aktualisht fokusi kryesor i punës është analiza dhe vlerësimi i pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UMT. Në përbërje të NJSBC-së janë: 3 personel akademik, 1 përfaqësues i studentëve, 1 ekspert i jashtëm dhe 1 përfaqësues i administratës. Gjithashtu edhe GVB gjithmonë ka në përbërjen e tij një student nga programi që akreditohet. Ndërkohë studentët përfshihen rregullisht në vlerësimin e stafit akademik dhe programit të studimit nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve që plotëson NJSBC, për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik, si dhe për përmbajtjen e lëndës. Studentët kontribuojnë në cilësinë e programit të studimit, edhe nëpërmjet angazhimit në Këshillat studentorë, të cilët mbajnë lidhje të ngushtë me Institucionin, Njësinë kryesore dhe veçanërisht me Njësinë bazë. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi 82. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.pdf; Aneksi Nr.44 Model i formularit të vlerësimit të performancës.pdf; Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.pdf]</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në UMT, GVJ konkludoi se NJSBC si strukturë përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie: - ia paraqet rezultatet e përpunimit të pyetësorëve Rektorit, Administratorit dhe Senatit Akademik për analiza të mëtejshme. - i dërgon një raport edhe Përgjegjësit të njësisë bazë për çdo anëtar të departamentit, i cili bën një analizë vjetore në departament ku merren vendimet përkatëse në funksion të rritjes së cilësisë së programeve të studimit që ofrohen, bazuar edhe në analizën e rezultateve të pyetësorëve. Rezultatet e përgjithshme të vlerësimit të brendshëm të Institucionit bëhen publike në faqen web të UMT, si dhe bëhen pjesë e raportimit vjetor për MAS. <i>[Aneksi 82. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneksi Nr.44 Model i formularit të vlerësimit të performancës.pdf; Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.pdf; Dokumenta shtesë_1.Raporti Vjetor 2022-2023-DFB.pdf]</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave	Referuar vizitës në Institucion, në takimin me stafin akademik të këtij program studimi GVJ konstatoi gadishmërinë e Institucionit



të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	për mbështetje për stafin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor (kryesisht në infrastrukturë), ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor- nxitja dhe mbështetja financiare për pjesmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, për të botuar artikuj në revista me faktor të lartë impakti- Scopus, monografi dhe botime të ngjashme shkencore. Gjithashtu aktiviteti shkencor i stafit akademik konvertohej në orë mësimore duke ndikuar në uljen e ngarkesës vjetore të tij. [Aneksi Nr.47 Ambjentet për Infrastrukturën FE-UMT.pdf; Aneksi Nr.44 Model i formularit të vlerësimit të performancës.pdf; Aneksi Nr.28 Plani i ngarkesës së programit sipas stafit.pdf; Vizita në Institucion]			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni harton periodikisht udhëzues në nivel institucional në shërbim të përmbushjes së misionit dhe vizionit të Universitetit. - Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, veçanërisht NJSBC dhe Departamenti Financë Bankë, vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik, raportojnë në instancat më të larta, si dhe i dërgojnë një raport të përpunuar përgjegjësit të njësisë bazë, duke reflektuar në vendimmarrjet e mëtejshme në kuadër të rritjes së cilësisë së programit të studimit. - Studentët përfshihen në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit të cilësisë, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, pjesmarrjes në komisionet e përhershme, si edhe këshillit studentor. - Institucioni është i angazhuar në nxitjen e personelit akademik në funksion të mësimdhënies dhe kualifikimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë	Referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se statuti i UMT (nenet 29-30) përcakton që Institucioni harton politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese dhe garantuese e

(SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit. Kjo njësi funksionon në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Statutin dhe në Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë së Institucionit. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi 82. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf]</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	NjSBC është organ kolegjal, anëtarët e së cilës propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati Akademik. NjSBC përbëhet nga gjashtë anëtarë, nga të cilët, tre janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, një përfaqësues i këshillit studentor, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i administratës. UMT ka hartuar Strategjinë e zhvillimit të institucionit si dhe Strategjinë 2022-2027 për UMT, ku evidentohet qartësisht përkushtimi në përmirësimin e punës së NjSBC dhe rritjen e cilësisë së programeve të studimit që ofrohen. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi Nr.4.Strategjia e Zhvillimit të UMT.pdf; Aneksi Nr.5.DraftStrategjia 2022-2027-UMT.pdf]</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UMT ka realizuar një proces vlerësimi të jashtëm në kuadër të akreditimit të këtij program studimi pranë ASCAL. Ky vlerësim u bë në vitin 2020, ku programi i studimit Bachelor në "Financë" me profile a) Kontabilitet dhe b) Bankë u akreditua për 3 vite akademike, me vendim të Bordit të Akreditimit nr.65, datë 18.02.2020. Aktualisht Programi i studimit Bachelor në Financë me profile a) Kontabilitet dhe b) Bankë është duke realizuar procesin e vlerësimit të jashtëm, për herë të dytë nga ASCAL. <i>[Aneksi Nr.8.Aplikim për akreditim programi.pdf; Aneksi Nr.6.VBA për akreditimin.pdf; Aneksi Nr.15.Dosja e Programit të Studimit.pdf]</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore	GVJ referuar dokumentave të dorëzuara dhe vizitës në Institucion, konkludon që NJSBC përpunon të dhënat duke llogaritur tregues sasiore dhe cilësore në lidhje me cilësinë e procesit mësimor në këtë institucion. Raportet e përgatitura iu dërgohen të gjithë strukturave sipas përcaktimeve në rregulloren e kësaj njësie. Strukturat drejtuese dhe në veçanti Departamenti Financë Bankë përgjegjës për këtë program studimi, dhe Fakulteti i Ekonomisë; marrin

institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor. [Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi 82. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf]			
Konkluzione	GVJ konkludon se: - Institucioni harton politika dhe procedura në funksion të sigurimit të cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregullatore. - UMT ka hartuar Strategjinë e zhvillimit të institucionit si dhe Strategjinë 2022-2027 për UMT ku evidentohet përkushtimi ndaj sigurimit të cilësisë. - NJSBC përgatit raporte me tregues sasior dhe cilësor, dhe ua dërgon strukturave përkatëse, të cilat marrin vendime në funksion të përmirësimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.	Bazuar në dokumentacionin e dërguar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstaton se në UMT aktiviteti i NJSBC-së ka një sistem raportimi vjetor (dy herë në vit, në fund të çdo semestri) dhe kryesisht në formën e një raporti analize mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, si dhe kurrikulën e çdo programi studimi. Aktualisht pyetësori është uniform për të gjitha programet e studimit që ofron UMT. Vlerësimet e NJSBC raportohen në strukturat drejtuese të përcaktuara në rregulloren e njësive. Ato janë pjesë e informacionit të paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit të institucionit si dhe përdoren nga njësitet bazë në analizën vjetore përkatëse. Kjo analizë konsiston në ecurinë e procesit mësimor, kërkimor shkencor dhe ndërkombëtarizimi, në rang institucioni, njësie kryesore, njësie bazë si edhe program studimi.

Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	[Aneksi 82. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; Dokumenta shtesë: 1.Raporti Vjetor 2022-2023-DFB.pdf; Aneksi Nr.15.Dosja e Programit të Studimit.pdf; Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.pdf]
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezulton se në mbledhjet e departamentit Financë Bankë në fund të çdo viti mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit. Mbështetur në analizën vjetore të njësive bazë, përgatitet edhe raporti i analizës vjetore për njësinë kryesore. Në këtë raport vjetor të vetëvlerësimit të Fakultetit të Ekonomisë, përcaktohen qartë objektivat kryesore në lidhje me procesin mësimor, kualifikimin shkencor dhe ndërkombëtarizimin. Ky raport përmban informacion të gjerë sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesin mësimor, vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, të cilësisë të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor, si dhe rekomandime e sugjerime për të ardhmen. [Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; Dokumenta shtesë: 1.Raporti Vjetor 2022-2023-DFB.pdf;Aneksi Nr.15.Dosja e Programit të Studimit.pdf]
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime	Në takimet me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë që mbulon këtë program studimi, GVJ-ja konstatoi se përdoren disa procedura periodike për vlerësimin e realizimit, të mbarëvajtjes dhe të cilësisë së programit të studimit në nivel Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti: - NJSBC përpunon pyetësorët e studentëve dhe analizon punën e personelit akademik dhe ndihmës akademik, si dhe kurrikulën e programit të studimit; - Drejtuesi i Departamentit Financë Bankë bazuar në raportin e NJSBC-së, raportin e këshilltarit akademik të këtij program studimi, realizon analizën vjetore të veprimtarisë së departamentit, ku merren vendime për ndryshime në funksion të përmirësimit të cilësisë. - Fakulteti i Ekonomisë harton raportin vjetor të në nivel njësie kryesore lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, të cilësisë të



ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	programeve të studimit dhe kërkimit shkencor, si dhe rekomandime e sugjerime për të ardhmen. Gjithashtu në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe Institucioni bëhen vëzhgime rastësore të zhvillimit të mësimin në auditor. <i>[Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; Dokumenta shitesë: 1.Raporti Vjetor 2022-2023-DFB.pdf; Aneksi Nr.15.Dosja e Programit të Studimit.pdf; Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.pdf; Aneksi Nr.35 Praktika e miratimit dhe permiresimit te kurikules per nje prog.pdf; Aneksi Nr.18.VD për emrimin e përgjegjesve të programeve dhe këshilltarve ak.pdf]</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ, bazuar në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe vizitën në Institucion, konkludon se UMT në kuadër të vlerësimit të cilësisë për programet e studimit përdor mekanizmat e mëposhtëm kryesorë: - Pyetësor për studentët për cilësinë e mësimdhënies së personelit akademik, si dhe për lëndët e kurrikulës së programit të studimit; - Pyetësor për rrjetin Alumni, në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit; - Diskutime me përfaqësues të rrjetit Alumni (round tables, guest lectures, program monitorimi, internships, etj.) në funksion të përmirësimit dhe rritjes së praktikitetit të këtij program studimi. Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe veçanërisht informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në Institucion GVJ konstatoi se roli i komunikimit me rrjetin ALUMNI (ish studentë) në lidhje me cilësinë e procesit mësimor dhe programet e studimit, është përmirësuar veçanërisht në udhëzimin e studentëve për tu bërë pjesë e tregut të punës, si dhe për realizimin e praktikave apo punësimit të studentëve aktualë. <i>[Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; Dokumenta shitesë: 1.Raporti Vjetor 2022-2023-DFB.pdf; Aneksi Nr.15.Dosja e Programit të Studimit.pdf; Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.pdf; Dokumenta shitesw : 4-Raporti Alumni UMT 2023.pdf;Dokumenta shitesw: 7-Te dhena nga pyetesori Alumni.pdf]</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - UMT ka një sistem raportimi duke llogaritur tregues sasior dhe cilësor bazuar në përpunimin e pyetësorëve të studentëve



	<i>për cilësinë e mësimdhënies, si dhe kurrikulën e këtij programi studimi.</i> - <i>Në nivel njësie bazë dhe njësie kryesore bëhen analiza vjetore të punës mësimore dhe kërkimore bazuar në përpunimin e pyetësorëve, informacionin e ofruar nga këshilltari akademik për programin e studimit, feedback-un e rrjetit Alumni, duke nxjerrë në pah arritjet dhe rekomandimet për të ardhmen.</i> - <i>Institucioni në kuadër të vlerësimit të cilësisë përdor një sërë metodash të tërthorta, që kryesisht lidhen me rolin e rrjetit ALUMNI në funksion të përmirësimit të këtij program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka ngritur strukturat që garantojnë sigurimin e cilësisë konform legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse. Këto struktura janë ngritur në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Struktura më aktive në këtë proces është NjSBC, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe veçanërisht me njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardet e cilësisë se UMT, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Strukturat e sigurimit të cilësisë kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Referuar statutit të UMT-së në këto struktura përfshihen personel akademik efektiv, personel ndihmës akademik, studentë si dhe aktorë të jashtëm si: ekspert sigurimi cilësie, lektorë të ftuar apo bashkëpunëtorë kryesisht përfaqësues të rrjetit Alumni, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UMT, në NJSBC, si dhe në hartimin e RVB për vlerësim të jashtëm pranë ASCAL. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi 82. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneksi Nr.39 Lista aktiviteteve (leksione te hapura).pdf; Aneks Nr.76-Rregullore e zyres se karrieres.pdf]</i>

Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, dhe statutit të UMT janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Në rregulloren e NJSBC, janë përcaktuar përgjegjësitë e njësive bazë që mbulon këtë program studimi si dhe njësisë kryesore përkatëse në funksion të sigurimit të cilësisë. Ndërkohë në çdo grup pune të ngritur në kuadër të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm përcaktohen detyrat për çdo anëtar të grupit të punës. Detyrat janë të përcaktuara qartë edhe për studentët kur këta janë të përfaqësuar në këto grupe vlerësimi. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që studentit të angazhuar në GVB për këtë program studimi, i ishin përcaktuar detyrat përkatëse që do të kishte në funksion të përgatitjes së RVB, kryesisht duke sjellë opinionin e studentëve për çështje që lidhen drejtpërdrejtë me ta. <i>[Aneksi Nr.2.Statuti i UMT.pdf; Aneksi 82. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneksi Nr.11Rregullore e FE në UMT.pdf; Aneksi Nr.14.Rregullore e programit të studimit.pdf]</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	UMT ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila ka për detyrë monitorimin në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë janë edhe Departamenti Financë Bankë dhe Fakulteti i Ekonomisë, si njësi bazë dhe kryesore që ofrojnë këtë program studimi. Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit, si staf drejtues, Përgjegjësi dhe Këshilltari akademik i programit të studimit, janë personeli akademik i angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë. Ndërkohë pjesë e këtij vlerësimi janë edhe personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, si pjesë aktive e analizës vjetore të Departamentit dhe Fakultetit dhe komenteve e sugjerimeve në funksion të përmirësimit të kurrikulës. Në vlerësimin e jashtëm të këtij program studimi janë angazhuar në GVB pesë anëtarë: tre personel akademik, një personel ndihmës akademik dhe një student. <i>[Aneksi 82. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneksi Nr.9.Vendim i Dekanit per krijimin e gGVB-s për programin e studimit.pdf; Aneksi Nr.18.VD për emrimin e përgjegjesve të programeve dhe këshilltarve ak.pdf; Aneks Nr.78-Pershkrim pune pergj. prog..pdf; Aneksi Nr.17.VSA Kompetencat & përgjegjesit e P të programeve dhe këshillta.pdf]</i>



Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ bazuar në informacionin në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe informacionin e vjelë gjatë takimit me stafin drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi konstaton se personeli akademik përfshihet në mënyrë aktive në proceset e vlerësimit të programeve të studimit, duke respektuar të drejtat dhe integritetin akademik të secilit prej tyre dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Përzgjedhja e anëtarëve të grupeve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm bëhet me vendim të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, bazuar në nenin 93 të Statutit të UMT. <i>[Vizita në Institucion; Aneksi Nr.9.Vendim i Dekanit per krijimin e GVB-s për programin e studimit.pdf]</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në funksion të rritjes së cilësisë janë lidhur një sërë marrvëshjesh në nivel Institucioni dhe në nivel njësie kryesore. Këto marrvëshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, mundësojnë organizmin e aktiviteteve të ndryshme si trajnime dhe workshop-e, leksione të hapura, organizimin e panairit të punës; etj. Gjithashtu mundësojnë realizimin e praktikave profesionale për studentë, si dhe shpesh luajnë rol aktiv në punësimin e studentëve. Zyra e Alumnit realizon plotësimin e një pyetësori, si dhe zhvillon aktivitete me përfaqësues të këtij rrjeti dhe në bashkëpunim të ngushtë me Departantin Financë Bankë, për të tërhequr opinionin e tyre në lidhje me cilësinë e programeve të studimit të ofruara nga ky departament. Pjesë e NjSBC është edhe një ekspert i jashtëm, i cili ofron një kontribut të vyer bazuar në eksperiencën profesionale. Gjithashtu këto opinione marrin një rëndësi më të madhe kur vijnë nga një profesionist jashtë këtij Insitucioni. <i>[Aneksi Nr.21 Lista e marrëveshjeve të bashkepunimit në kuadrin e praktikave.pdf; Aneksi Nr.20.Lista e marrëveshjeve në kuader të programeve të FE.pdf; Aneksi Nr.39 Lista aktiviteteve (leksione te hapura).pdf; Dokumenta shitesë: 4-Raporti Alumni UMT 2023.pdf]</i>
Konkluzione	GVJ konkludon se: - Institucioni ka ngritur strukturat që garantojnë sigurimin e cilësisë në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë, të cilat kanë në përbërje të tyre personel akademik, ndihmëskademi dhe studentë. - Përzgjedhja e anëtarëve të strukturave të vlerësimit të cilësisë bëhet në respekt të integritetit akademik, duke shmangur diskriminimin apo pabarazinë.

	- Anëtarët e njësive të sigurimit të cilësisë kanë të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. - Pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë edhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm, vecanërisht përfaqësues të rrjetit Alumni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, si dhe të marrë gjatë vizitës në UMT, GVJ konstaton se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen Web të tij, të të gjitha veprimtarive (statute, rregullore) përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti. Informacioni në nivel njësie bazë përcillet nga NjSBC. Ndërkohë që njësia bazë organizon analizën e punës vjetore të departamentit, që bazohet në raportin e NjSBC-së dhe përpunimin e formularëve të vetvlerësimit të personelit akademik. Studentët informohen përmes njësisë bazë për problematikat që mund të shfaqen në lidhje me cilësinë. <i>[Aneksi 82. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; www.umat.edu.al]</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Bazuar në informacionin e RVB-së dhe vizitën në UMT, GVJ konstaton se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen web të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti. GVJ konsultoi faqen web të Institucionit dhe konstatoi se publikimet aktuale në lidhje me rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Rezultatet që dalin nga përpunimi i pyetësorëve nga NJSBC ju dërgohen instancave të larta dhe përgjegjësve të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Drejtuesi i njësisë bazë komunikon individualisht me personelin akademik për rezultatet e pyetësorit të studentëve.

	Njësia bazë bën analizën e punës vjetore të departamentit duke përcaktuar dhe objektivat për të ardhmen. Analizë e punës vjetore bëhet edhe në nivel njësie kryesore, duke përcaktuar objektivat për njësinë kryesore, njësitë bazë si edhe programet respektive që ofrohen. <i>[Aneksi 82. Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; Dokumenta shitesë: 1.Raporti Vjetor 2022-2023-DFB.pdf]</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstaton se njësia bazë, mbas marrjes së raportit nga NjSBC, informacionit nga përgjegjësi dhe kordinatori akademik i programit të studimit, realizon analizën e punës vjetore të departamentit duke vendosur dhe objektivat për të ardhmen. Analizë e punës vjetore bëhet edhe në nivel njësie kryesore, duke përcaktuar objektivat për njësinë kryesore, njësitë bazë si edhe programet respektive që ofrohen. <i>[Aneksi 82. Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; Dokumenta shitesë: 1.Raporti Vjetor 2022-2023-DFB.pdf; Aneksi Nr.15.Dosja e Programit të Studimit.pdf; Aneksi Nr.18.VD për emrimin e përgjegjesve të programeve dhe këshilltarve ak.pdf; Aneksi Nr.17.VSA Kompetencat & përgjegjesit e P të programeve dhe këshillta.pdf]</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ bazuar në informacionin në RVB, dokumentacionin shoqërues si dhe vizitën në UMT konstaton që Institucioni e ka fokusuar kryesisht monitorimin e cilësisë nëpërmjet evidentimit të problematikave nga NjSBC dhe Njësia Bazë. Bazuar në raportet e përgatitur nga NjSBC dhe analizën vjetore të departamentit Financë Bankë dhe njësive të tjera bazë, hartohet periodikisht raporti për programin e studimit. Në këtë raport analizohet ecuria e këtij program studimi, në kuadër të përmirësimit në vijim të cilësisë së tij. Gjatë vizitës në insitucion GVJ-së iu konfirmua nga drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse të programit të studimit, angazhimi për të përmirësuar programin e studimit në kuadër të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë, duke u bazuar në problematikat e ndeshura si dhe ndryshimeve të kërkesave të tregut. Aktualisht Departamenti Financë Bankë, është duke aplikuar për të licensuar këtë program Bachelor në Financë, por me profile Kontabilitet dhe FinTech, duke u fokusuar në ndryshimet që kushtëzon tregu.



	[Aneksi Nr.60 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2022.pdf; Dokumenta shitesë: 1.Raporti Vjetor 2022-2023-DFB.pdf; Aneksi Nr.15.Dosja e Programit të Studimit.pdf]			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në Institucion GVJ konstaton se veprimtaritë periodike me personelin dhe studentët në funksion të këtij kriteri lidhen me aktivitete informuese me studentë, publikime në faqen web të UMT, platformën edu4school, GoToMeeting, Teams, email me domenin e UMT, si dhe publikime në rrjetet sociale të administruara nga departamenti Financë Bankë, me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. [Aneksi Nr.56 Manuale edu4school, sistemi i emails.pdf; Dokumenta shitesw: 4-Raporti Alumni UMT 2023.pdf; www.umat.edu.al]			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen web të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. - Njësia bazë realizon analizën e punës vjetore, ku përfshihet edhe analiza e programeve të studimit duke përcaktuar objektivat për të ardhmen. - Drejtuesit e njësive bazë dhe njësive kryesore në sajë të problematikave të ndeshura dhe ndryshimet në tregun e punës angazhohen në funksion të përmirësimit në vijimësi të cilësisë së programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë me profile “Kontabilitet” e “Bankë” ofruar nga Universiteti “Metropolitan Tirana”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni disponon një sistem menaxhimi efektiv, i cili ka të integruar dy platforma: “edu4school” dhe “GoToMeeting”, të cilat mundësojnë një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
2. Kujdesi ndaj studentit. Këshilltarët akademikë dhe koordinatori i programit qëndrojnë shumë pranë tyre duke evidentuar nevojat, problematikat dhe sugjerimet për programin.
3. Personeli akademik. Në këtë program studimi janë të angazhuar një numër i konsiderueshëm personel akademik me tituj e grada dhe eksperiencë të gjerë në fushën e ekonomisë.
4. Infrastrukturë koherente, e mirëpajisur dhe e pasur në laboratorë mësimorë të pajisur me programe dhe software të nevojshëm dhe të përshtatshme për aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve. UMT ka hapur edhe një Inovation Center (Metropolitan Inovation Center) që do të shërbejë për aktivitete dhe nisma që kanë në qendër teknologjinë e informacionit.
5. Institucioni ka nënshkruar një numër marrëveshje bashkëpunimi me institucioni publike dhe private, duke u mundësuar studentëve nëpërmejt zyrës së karrierës dhe ALUMNI-t një sërë aktivitete, ku përfshihen edhe zhvillimi i praktikave mësimore dhe mundësia për punësim.

Pika të dobta:

1. Investimi në literaturë është i kufizuar, si përsa i takon fondit fizik të titujve në bibliotekë, ashtu edhe regjistrimit në biblioteka online. *(Standarti IV.3, kriteri 1)*
2. Numri shumë i lartë i personelit akademik me kontratë të angazhuar në këtë program studimi, në krahasim me numrin e personelit akademik efektiv. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet ngarkesa mësimore që mbulon personeli akademik efektiv është shumë e lartë (rreth 72%). *(Standarti IV.1, kriteri 1)*

Rekomandime:

5. Të shtohen investimet në fondin fizik në bibliotekë, si dhe të bëhet regjistrimi në biblioteka prestigjioze online, në funksion të rritjes së cilësisë së këtij program studimi. *(Standarti IV.3, kriteri 1)*
6. Të rregullohet raporti ndërmjet PAK dhe PAE, pasi numri i PAK është shumë i lartë. GVJ vlerëson nivelin e kualifikimit dhe eksperiencën e PAK, por duke konsideruar



rëndësinë që ka PAE në ofrimin e një programi studimi, sugjeron që të rritet mbulimi i këtij programi mësimor me personel akademik efektiv, në krahasim me personelin akademik me kontratë. *(Standarti IV.1, kriteri 1)*

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle, Bachelor in "Finance" with profiles "Accounting" and "Bank" at the HEI "Metropolitan University of Tirana"

Strengths and affirmations:

1. The Institution has an effective management system, which has integrated two platforms: "edu4school" and "GoToMeeting". These platforms enable an interactive communication with students, and information exchange, increasing the quality of teaching and learning.
2. The caring and support for students. The academic advisors and the program coordinator are very close to the students, identifying their needs, problems, and suggestions for the program.
3. The academic staff. A considerable number of academic staff with titles and degrees, as well as appropriate expertise in the field of economy are engaged in this study program.
4. Coherent, well-equipped, and rich infrastructure in teaching laboratories equipped with programs and software appropriate for the practical and scientific knowledge of students. UMT has also opened an Innovation Center (Metropolitan Innovation Center) that will serve for activities and initiatives which are focused on information technology.
5. The institution has signed a number of Memorandum of Understanding (Cooperation Agreements) with public and private institutions, enabling students through the career office and ALUMNI a series of activities, including the internships and the opportunities for employment.

Weak points:

1. The investment in literature is limited, both in terms of the physical fund of titles in the library, as well as registration in online libraries. *(Standard IV.3, criteria 1)*
2. The high number of Academic Personnel with Contract (PAK) engaged in this study program, compared to the number of Effective Academic Personnel (PAE). However, it is important to note that the program teaching hours covered by the Effective Academic Personnel is very high (about 72%). *(Standard IV.1, criteria 1)*

Recommendations:

1. To increase investments in the physical fund of titles in the library, as well as to register in prestigious online libraries, to increase the quality of this study program. *(Standard IV.3, criteria 1)*
2. To take care of the adjustment of the ratio between PAE and PAK, as the number of PAK is very high. GVJ appreciates the level of qualification and experience of PAK



but considering the importance of PAE in providing a study program, suggests the engagement of more PAE staff in this study program, compared to PAK. (*Standard IV.1, criteria 1*)



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X



